



PRANUAR ME: 13/05/2026
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO: 02/145
FILM Nr.:



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi Komunal Malishevë

PROCESVERBAL

i mbledhjes së-III- (tretë) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e rregullt datë, 30.03.2026.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të të hyrave dhe shpenzimeve janar- mars për vitin 2026.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të Kuvendit Komunal Malishevë për periudhën Janar-Tetor 2025.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit lokal për riintegrim.
5. Formimi i Këshillit Organizativ për kremtimin e 16 Qershorit , Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/49, datë: 02.03.2026.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/50, datë: 03.03.2026.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/100, datë: 02.04.2026.
9. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajtë me datën: 30.04.2026 dhe filloi në ora:09:15.

Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 23 Asambleistë,Drejtori për Administratë të Përgjithshme z.Argjend Thaçi, Drejtori për Urbaznizëm z.Avdi Morina,Drejtori për Ekonomi dhe Financa z.Blerim Thaçi,Drejtori i Inspektoriatit z.Jakup Gashi,Drejtoresha për Kultur,Rini dhe Sport znj.Teuta Miftari–Mazreku,Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale z.Amrush Helshani,Drejtori për Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim Rural z.Sylë Dukolli,Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm z.Arbër Kastrati,Drejtoresha për Prona znj.Mirlinda Gashi,zyrtar ligjor z.Muharrem Morina,përfaqësues nga OSBE-së,zyra për informim si dhe RTV Malisheva.

Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z.Fatmir Ademaj.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Përshëndetje!Mirëse keni ardhur në mbledhjen e tretë të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës,para se me filluar me rendin e ditës e lusë sekretarinë e Kuvendit të na njoftojë se a janë plotësuar kushtet për të filluar me seancën.Pasi është konstatuarë që egzistonë korum i mjaftueshëm për të filluar me seancën e hapi debatin jashtë rendit të ditës për Asambleistat në periudhën kohore prej tri dhjetë minuta kush dëshironë me marrë fjalën?Fjalën e ka kërkuarë Vetoni pasataj Valejta.Urdhëroni!

Veton Zogaj(anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Përshëndetje kolegë Asambleistë,Kryesus,antarë të qeverisjes Komunale.Ne në vazhdimësi po ngrisim qështje këtu të cilat na vijnë direktë nga qytetarët e Malishevës,mirëpo quditërishtë nuk marrin përgjigje nga Drejtorët dhe Kryetari i Komunës,nuk e di i cili ka qenë në ndonjë mbledhje prej se ka filluar mandanti të paktën në pjesë e parë të seancës për me vazhduarë më tutje,mirëpo as prezentë nuk është kohët e fundit,si do që të jetë ne do të vazhdojmë me i ngritit qështjet të cilat besojmë që janë në interesë të qytetarëve,të cilat janë hallet dhe problemet të cilat ata ballafaqohenë gjdo ditë.

Këtë qështje e kam ngritur edhe një herë më parë,e para qështje është e mungea e energjisë elektrike në rrugë "Asim Vokshi" këtu në qendër të Malishevës,janë afërsishtë pesëmbëdhjetë shtëpi,janë pesëmbëdhjetë familje që jetojnë në atë pjesë është lagje e re mirëpo as Komuna e as Kedsi që janë përgjegjës për vendosjen e rrjetit elektrik nuk marin përgjegjësi për me zgjedhur këtë problemë me të cilën ballafaqohenë ata që sa kohë.Kanë pasur petition,kanë pasur kërkesa,janë adresuar në Drejtoritë përgjegjëse në Komunë mirëpo asnjëherë nuk është trajtuarë kjo qështje.Unë besojë që është momenti i fundit që Kryetari duhet me trajtuarë këtë pjesë shumë jetike për banorët e Komunës së Malishevës.

Gjithashtu edhe në rrugën "Ilaz Agushi "në Malishevë,besoj që Drejtori i Urbanizmit qenka këtu e dinë në qfarë gjendje është ajo rrugë,nuk po flasim për një zonë të thellë që nuk ka as qytetarë atje por është një rrugë prej rrugëve kryesore në lagjën e Gurit në Malishevë e cila është në gjendje të mjerushme dhe Komuna nuk e trajtonë e cila nuk ka mundur me asfaltuarë apo riparuarë atë rrugë e cila ka nevojë.

Drejtoresha e arsimit nuk qenka këtu,mirëpo prej shumë qytetarëve kam marrë informacione që shumë Drejtorë janë ushtrues detyre e që fatëkeqësishtë e që konkursi nuk shpallet që sa vite,ata vazhdojnë të mbesin pengë në Drejtorinë e Arsimit dhe të Kryetarit.Kam marrë shumë shenime që

stafi i cili është angazhuarë aty, shumica e tyre janë me orë të pa plotësuar, do me thënë kanë normë të pa plotësuarë, angazhohenë aty dhe mbesin pengë vetëm në kohë fushate dhe disa prej tyre edhe largohenë. Dëshirojë me ditë sa është numri më tepër se sa që kanë mbulueshmëri në pagë? Sa kemi stafë më tepër sepse unë e kam një shifër që mbi tri dhjetë mësimdhënës janë mbi normë të lejuarë që ka Komuna e Malishevës si stafë në sektorin e arsmi? Shumica e tyre detyrohenë me lëvizur prej një shkollë në shkollën tjetër sepse mësimdhënësit që janë të atij fshati vazhdojnë të mos i respektojnë do me thënë i dërgojnë në shkolla tjera duke e pasur vendin aty sepse ka ardhur dikush tjetër nga fshatrat tjera aty të cilët vijnë me dritë të qeverisjes komunale.

Më duhet me falenderuar Drejtorin z. Blerim Thaçi sepse në dy seanca më herët, në seancën e parë kur e kam ngritur qështjen e stafit të shëndetësisë të cilët nuk janë paguarë për një kohë të gjatë pagat e tyre, drejtori e ka marrë përsipër dhe e ka trajtuar qështjen dhe pagesat i kanë kryer, stafi i shëndetësisë më ka njoftuar menjëherë që pagesat i kanë kryerë por besoj që kjo punë është kryer edhe falë mundit tonë që e kemi dhënë edhe ne këtu si Asambleistë. Ju e dini se kush është përfaqësues i sindikatës së puntorëve, ai është nipi i Kryetarit i cili shantazhonë së bashku me Drejtorin dhe Zëvendës drejtorin këtë qështje e kam ngritur edhe herën e kaluar z. Amrush ju lutem merini masat respektojeni ligjin, shpallen konkursin, zgjidheni Drejtorin e QKMF-së ashtu siq e kërkonë ligji, mos i leni njerëzit të cilët nuk janë kompetentë, të cilët punën e vet e kanë aty me shantazhuarë stafin.

Gjithashtu prej profesionistëve shëndetësor pikërisht në QKMF janë disa pajisje që në raste emergjente nuk punojnë, disa prej neve jemi detyruar të intervenojmë aty, pajisjet që janë aty nuk funksionojnë janë me afat të skaduarë. Merni masat përmirësoni kushtet atje që mos të kemi fatëkeqësi siq patëm në rastin e fundit. Ju faleminderit shumë.

Kryesus i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Veton. Urdhëro znj. Valjeta Hoti.

Valjeta Hoti (anëtare nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës): Faleminderit Kryesus. Përshëndetje për të gjithë. I nderuar Kryesus, stafi Ekzekutiv dhe ju kolegë Asambleistë. Duke u bazuar në zhvillimet e fundit që kanë ndodhur në Komunën tonë i kam disa pyetje për Ekzekutivin. Sa i përket mbështetjes për fermerët e konsideroj që gjdo ndihmë është e domosdoshme dhe e mirëseardhur por në rastin e bashkëpunimit të Komunës me organizatën e Islamik Relief Kosovo. Pse nuk është bërë publike në faqën zyrtare të Komunës shpërndarja e atyre

mjeteve? Postimin që unë e pashë i cili është publikuar në media lokale, e pashë që kishte nxitur reagime të shumta prej qytetarëve dhe në bazë të asaj që lexova e pashë që patë edhe prej atyre që e kanë cekur që kanë aplikuar disa herë për gjatë këtyre viteve dhe fatëkeqësisht nuk janë përfshirë andaj po ju pyesë. A janë mundësitë e barabarta për të gjithë fermerët dhe realishtë kjo mbështetje e fermerëve ndërvite a ka ndikuar në rritje e prodhimit bujqësorë apo mbetet vetëm një ndihmesë simbolike? Sa i përketë pyetjes tjetër ka të bëjë me rastin e fundit të zjarrit në QKMF, unë uroj që mos të ndodhin më por rastet e tilla mundë të ndodhin edhe në institucionet e tjera publike? Në Komunën tonë a janë të gjitha pajisura me sistem mbrojtës kundër zjarrit përfshirë edhe shkollat? A mbahenë ligjerata dhe a trajnohenë stafet në raste të tilla emërgjente? Rastet e tilla kanë pasoja reale, përgjegjësinë duhet ta mbajë dikush dhe për këtë arsye mendojë që këto raste duhet të trajtohenë dhe nuk duhet të kalohenë vetëm si incidente të izoluara. Ju faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit znj. Valejta Hoti. Fjalën e ka kërkuar z. Enver Hoti.

Enver Hoti (anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës): Faleminderit Kryesus. Përshëndetje të nderuar kolegë Asambleistë, të nderuar media, qytetarë të Malishevës. Unë edhe një herë e kam ngritur këtë qështje në seancën e kaluar për vendim e pronave nëpër fshatra që e ka marrë Kuvendi Komunal, gjatë kësaj periudhe nga vendimet që kanë dalur nga kjo Komunë, Asamble deri më sot me dhjetra shqipëfolës që kam takuar më janë ankuarë për atë vendim që e keni marrë arsyeja është e tillë mos i ngatroni njerëzit sepse nuk ka bazë për zhvillim të mëtutjeshëm sepse nuk është as në interesë publik e as institucional.

Nëse keni qëllim për ndonjë pronë të caktuar mos e përzini të gjithë Komunën me bërë siq thotë populli lëmësh. Unë i bëjë thirrje Kryetarit, qeverisjes komunale, imazhorancës që është këtu të bëjë kujdes me vendimet që i merrë sepse do të kenë pasoja.

Gjithashtu edhe një temë tjetër do ta ngriti, unë i shprehi ngushllime familjes në Gurëbardh për rastin që ka ndodhur por kjo është një shenjë për me treguar se ku gjindemi si institucione në masat të cilat janë për sigurin e qytetarëve. Ne jemi duke e parë se qfarë është duke ndodhur me këto ndërtime, janë me gjasa jashtë kritereve obligative inzhinierike në të gjithë fushën e funksionimit të tyre është mirë me marrë si shembull fatëkeqësisht do të thoja. Drejtori i Bujqësisë qenka këtu atëherë ju them kujdes se janë duke i keqpërdorur janë i shitur mjetet ka raste që ka përfituar para

një ose dy vite dhe prapë i kanë ndarë pajisje. Unë nuk jam kundër për me i ndihmuar nuk ka lidhje nëse i kanë bindjet e ndryshme politike vetëm mbështeti aty ku ka nevojë por jo në një fshatë ti grumbulloni aty vitë pas viti sepse është një pabarazi për qytetarët sepse të gjithë janë taksa pagues të gjithë janë qytetarë të gjithë kanë nevojë për mbështetje institucionale. Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Enver Hoti. Fjalën e ka kërkuar Mërgime Robaj Gashi. Urdhëro!

Mërgime Robaj Gashi (anëtare nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës): Faleminderit Kryesues. Përshëndetje kolegë Asambleistë. Dua të ngrisë si shqetësim gjendjen e shtratis të lumit në fshatin Vërmicë i cili si pasojë e vërshimeve të shpeshta, gjdo vitë shkaktonë vështirësi në qarkullim të qytetarët në afërsi të këtij shtrati ndodhet edhe Gjamia ku përveqë aspekti fetarë kryhenë edhe shërbime të tjera pastrimi i kufomave të banorëve të fshatit dhe banorëve për rreth kjo e bënë edhe më të ndjeshme ndërhyrjen në këtë zonë, pra për të treguar edhe më të kuartë situatën kam sjellur edhe fotografi që e ilustronë gjendjen e fshatit dhe rrugët gjatë rreshjeve. Këto pamje dëshmojnë vështërsitë që përballen qytetarët tanë. Për këtë arsye kërkojë prej Ekzekutivi Komunal që të ndërmer masa urgjente për rregullimin dhe zgjerimin e fshatit prej numrit të gjatësisë jo më pak se 2 kilometra në mënyrë që të parandalohet përsëritja e vërshimeve dhe të shmangenë bllokimet e qarkullimit dhe të garantohet siguria e qytetarëve për objektet për rreth është e rëndësishme që kjo ndërhyrje të realizohet me urgjencë para përfundimit të këtij viti me të cilën presë përgjigje konkrete pra për këtë rrugë kam edhe fotografi për të cilën bëhet fjalë. Faleminderit shumë.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit znj. Mërgime. Fjalën e ka kërkuar z. Hafir Rexha. Urdhëro.

Hafir Rexha (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Faleminderit Kryesues. Përshëndetje Drejtorë të qeverisjes Kastrati, kolegë dhe kolege Asambleistë dhe qytetarë të dashur. Unë për dallim nga parafolësit e mi, unë dua të falenderojë Kryetarin z. Kastrati për formimin e një taksëforce e cila i ka senzibilizuarë qytetarët dhe njëkohësishtë i tërë muaji prill është shpallur si muaji i pastrimit. Gjatë vizitave apo pastrimit në teren unë kam hasur që pothuajse afërsishtë 90% të Asambleistëve nuk ju kemi bashkangjitur këtij aksioni që në njërën anë bënë pastrimin e ambienteve tona prej materialeve inerte nën dy e senzibilizonë qytetarin e ngritë një

vetëdijësim të qytetarëve dhe nën tre e ka bërë një lidhshmëri një korelacion në mes të qytetarëve dhe ekzekutivit ka bërë një njoftim për njerëzit e papërgjegjshëm që i hedhin mbeturinat inerte vend e pa vendë e për këtë jam mirënjohës ekzekutivit dhe Drejtorive përkatëse. Qeverija Kastrati edhe në mandatin e kalaur e ka bërë transformimin e qytetit është shumë normale që ka kërkesa të tjera për renovimin e rrugëve asfallimin e tyre ,rregullimin e kanalizimeve dhe gjësendeve të tjera sepse ato janë të ndërhuara por ato kanë nevojë për renovim si dhe për kërkesat e tjera të lumenjëve që janë parashtruar. Mirëpo kur po është te qështja e miratimit të buxhetit e kërkesave ju nuk po votoni. Unë nuk e di se si po bëjnë kërkesa si Asambleistë kur vetë në buxhet as nuk propozojnë as nuk marrin pjesë as nuk votojnë dhe pastaj dalin këtu në Asamble kërkojnë për qytetarët mbështetje për ndonjë kërkesë. A e keni votuar buxhetin? Jo. A keni bërë kërkesë? Jo. Ku me i marrë ato mjete për me bërë rregullimin e asaj rruge apo shtarati e shumë të tjera. Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Hafir. Fjalën e ka kërkuar z. Veton Zogaj. Urdhëro.

Veton Zogaj (anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje): Faleminderit. E para e di që e keni me shumë zellë për me mbrojtur Kreytarin mirë që e bëni por kur është i pambrojtur nuk mundemi me mbrojtur edhe ne e vlerësojmë punën që e kanë bërë për pastrimin e hapsirave. Por me dalur këtu dhe me thënë po sjelli kërkesa dhe ju nuk e keni votuar buxhetin. A e keni sjellur ju draft buxhetin dhe me pyetur cilat janë kërkesat e opozitës? Së paku mos u bëni i pasinqertë dhe me foluar qka të ju vie në mendje.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Hafir Rexha e ka kërku fjalën për replikë. Urdhëro.

Hafir Rexha (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): I nderuar Asambleistë është e vërtetë që ndoshta keni sjellur kërkesa. A keni marrë pjesë në dëgjim publik? A e keni parë statusin tëndë sot që e keni bërë për znj. Vjosa Osmani? Jeni duke bërë politikë mos jetoni me standarde të dyfishta, qytetarët e Republikës së Kosovës janë ata që të kanë jepur votë edhe për atje lartë që ti je që pesë vite atje. Qka keni bërë ju që pesë vite për Komunën tënde? A keni marrë pjesë në dëgjim publik që është mbajtur? Ju nuk keni marrë pjesë asnjëherë.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Veton Zogaj e ka kërku fjalën për replikë. Urdhëro.

Veton Zogaj(anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje): A dëshironi ti numërojmë?Jemi duke e trajtur qëstjen e nivelin lokal,me dalur këtu dhe me keqpërdorur foltoren se ne nuk kemi pasur kërkesë si opozitë sepse ju do ta kishit mbështetur mos fol pa skropulltur nuk ju lejojë.Ne kemi pasur kërkesa konkrete por nuk kanë kaluar nuk kanë gjetur mbështetje.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Ju ftojë që ta ruani gjuhën e komunikimit.Fjalën e ka kërkuar z.Enver Hoti.Urdhëroni.

Enver Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës):Qyeti i Malishevës është e vërtetë që është transformuar,por është transformuar edhe buxheti,nëse e shikonë raportin e auditorit të përgjithshëm e vërenë edhe transformimin e buxhetit,nuk po flasë më shumë kësaj rradhe.Merreni dhe shikojeni raportin e auditorit e shikoni edhe transformimin e buxhetit ajo pjesa e dytë ne kemi bërë kërkesa,propozime edhe për buxhet nuk kanë kaluar sepse nuk e kemi shumicën ju qe e keni shumicën e keni votuar kanë kaluarë por ato mbetën në interes të qytetarëve dhe më së miri e dinë qytetarët dhe ata e vlerësojnë.Kryesus tani janë fushtat në nivel qëndrorë për këto dy partitë që janë në nivel lokal mos u shqetësoni sepse nganjëherë acarohenë punët i bëjnë bashkë dhe punët i kanë mirë pak kanë bërë për Malishevën.

Që pesë vite që janë në pushtet LVV-ja në nivelin qëndrorë me miliarda eruo janë shpenzuar,e kanë vizituar deputetët,kandidatët i kemi parë fotografitë ata i kanë parë gropat në rrugët e Malishevës,qytetarët tanë janë ende duke u ballafaquar me këtë situatë,ata i kanë veturat e mira dhe menjëherë i kanë dërguar në servisë sepse ju kanë rënë në gropa,ata atje po vazhdojnë me njëzet miliard euro niveli qëndrorë që janë menagjuar gjatë kësaj periudhe kurse për Malishevën zero.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Enver Hoti.Fjalën e ka kërkuar z.Hafir Rexha për replikë.Urdhëro.

Hafir Rexha(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Unë kundër replikën dëshirojë me thënë me thënien e z.Enverit me qetësi dhe dashuri.Shoku Enver me të vërtetë Malisheva është transformuar normal që ajo nuk bëhet pa buxhet e sa i përket asaj të nivelit qëndrorë që e thatë jam plotësisht dakort me shokun Enver.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Hafir.Fjalën e ka kërkuar z.Burim Paqarizi.Urdhëro.

Burim Paçarizi(anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Përshëndetje kolegë,Drejtorë ekzekutiv dhe qytetarë të nderuar të Komunës së Malishevës.Unë së pari i shprehi ngushëllime familjes Berisha për rastin e fatëkeqësisë që ka ndodhur disa ditë më parë,shpresojë që këto raste mos të përsëriten sepse janë të ndjeshme,të cilat natyrishtë na bëjnë të ndjihemi edhe ne shumë keq sepse edhe ne e kemi bashkë ndje këtë fatëkeqësi.Ne e kemi një shqetësim të vazhdueshëm por mirë që qenka edhe Drejtori i Urbanizmit këtu,mirëmbajtja e rrugëve në qytetin tonë duhet të merret seriozishtë,mirë që e tha edhe z.Hafiri që buxheti është shpenzuar për transformimin e qendrës por qytetarët në vazhdimësi kanë ankesa për qështjen e gropave por besoj që edhe ju vetë keni probleme me gropa në fshatin Panorc edhe ju e dini gjendjen siq është.

Qështjet tjera janë problemet e kanalizimit,ne ditëve të fundit kemi marur shumë thirrje nga banorët e disa fshatrave,ndoshta duhet edhe ne me dalur në terren dhe me bërë një analizë më të mirë sepse duhet të interevenohet sepse qështja e kanalizimeve është më emërgjente se sa qështja e rrugëve sepse kemi të bëjmë me qështjen e higjienës me sëmundjet që munden me ndodhur nëse ato kanalizime bllokohenë ose dalin mbi sipërfaqe.Ne kemi një rast në fshatin Guriq,në fshatin Dragobil i kemi disa shtëpi që nuk kanë fare qasje në kanalizim do ti tregojë edhe Drejtorit në vazhdim se për cilat shtëpi bëhet fjalë,kaq e kisha sa për fillim.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Burim.Fjalën e ka kërkuar z.Halil Morina.Urdhëro.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit Kryesus i Kuvendit.Përshëndetje kolegë Asambleistë,Drejtorë të qeverisjes komunale.Unë dëshirojë të ndërlihem te qështja e bujqësisë meqenëse Drejtorin e Bujqësisë e kemi prezentë këtu.Por paraprkishtë më lejoni të shprehi ngushëllimet e mija familjes Berisha për atë fatkeqësi me fatalitet që na ka prekur të gjithëve secilit prej neve shpresojë që mos të ndodhin mo raste të tilla në Komunën tonë.

Sa herë që ka ndodhur fatkeqësi qoftë të karakterit natyrorë apo incidente të tilla,unë me të vërtetë ndjejë turp kur shohë edhe prej kolegëve të mijë këtu që menjëherë në ditën e ngjarjes shprehin ngushllime të cilët e bëjnë përmes postimeve në rrjetet sociale që në dy rreshtat e parë shprehin

që ndjejnë keqardhje dhe menjëherë del aty me akuza ndaj qeverisjes komunale. Akoma pa u ditur rrethanat se si ka ndodhur rasti, cilat janë shkaqet e asaj fatëkeqësie e cila ka ndodhur është krejtë noramle me kërkuar prej organeve qoftë të nivelit komunal ose të nivelit qendrorë për shkaqet ose nëse nuk i kanë marrë masat e duhura.

Por pritni njëherë të bëhenë dy ditë. A ka mundësi postime me i ndarë në dy pjesë, një herë me shprehë ngushllimet keqëardhjen dhe pas dy dite me u marrë me atë pjesë nëse dikush i ka fajet për atë fatëkeqësi e cila ka ndodhur.

Sa i përket qështjes së bujqësisë e kam një pyetje për Drejtorin e Bujqësisë por edhe një rekomandim. Të gjithë ne e dim që Komuna e Malishevës është kryesishtë tokë bujqësore e më shumë blektorale andaj investimet në bujqësi janë të domosdoshme.

Një qeveri e mirë matet me atë se sa është e aftë ta shpenzojë buxhetin e saj por qeveria akoma më e mirë është ajo qeveri e cila përveq mundësive të veta financiare gjenë kanale dhe bashkëpunime dhe shtonë buxhetin e Komunës së vetë për qytetarët, kështu që unë e falenderojë për këtë Kryetarin e Komunës e specifikishtë Drejtorin e Bujqësisë z. Sylë Dukollin që ka gjetur bashkëpunim me organizata të ndryshme siq janë ajo e Chatary, Islamik Relief Kosova dhe në bazë të këtij bashkëpunimi në mandatin e kaluar qytetarët e Komunës së Malishevës kanë përfituar më shumë se një milion euro në sektorin e bujqësisë. E si mos të përshëndetet dhe të mos falenderohet një punë e tillë. Organizata të cilat ne kemi filluar bashkëpunim me ato i kanë komisionet e veta, ata zgjedhin në bazë të kriterëve e vizitave që i bëjnë aplikuesit.

Unë nganjëherë e them që më të drejtë janë ata të cilët vijnë nga një vend i largët më shumë mbajnë drejtësi se sa që ne jemi në vendin tonë. Ka njerëz që kanë aplikuar dhe ka njerëz që kanë aplikuar dhjetë herë por ndoshta nuk i kanë plotësuar kriteret kurse ka njerëz që kanë aplikuar për herë të parë dhe kanë përfituar, ata janë qytetarë të Komunës së Malishevës. Pyetja të cilën unë e kam për Drejtorin e Bujqësisë është: Drejtor a keni me vazhduar prapë bashkëpunimin me këto organizata, a jeni duke hulumtuar ndonjë bashkëpunim të ri me ndonjë organizatë tjetër për të ju dalur në ndihmë qoftë për sektorin e bujqësisë ose ndonjë sektorë tjetër?

Në të njejtën kohë të inkurajojë dhe të rekomandojë me vazhduar bashkëpunimin me këto organizata sepse kjo është një punë e mirë dhe na ja shtojmë buxhetin qytetarëve të Komunës së tonë. Faleminderit shumë.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Halil.Fjalën e ka kërkuar z.Imran Xhyliqi.Urdhëro.

Imran Xhyliqi(anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Faleminderit shumë Kryesues.Përshëndetje të nderuar antarë të Kuvendit Komunal.Së pari Kryesues unë e kam një vërejtje,kritikë për mbledhjen e KPF-së,së paku thirja për mbledhjen e rradhës mos na dërgoni brenda 24 orëve sepse ndoshta nuk po kemi as mundësi me parë,herën e kaluar ka qenë mbledhje e jashtëzakonshme,urgjente kur e shikonë rendin e ditës e vërenë që nuk ka diçka aq shumë urgjente që të thiret ajo mbledhje.

E dyta unë do të ndalem te shkolla në fshatin Marali prej nga edhe vijë me qenëse sot është dita e shkollës ju urojë të gjithë nxënësve dhe mësuesëve aty,por kam edhe një shqetësim që e kam ngritur edhe në mbledhjen e kaluar kur një arsimitare del në pension nuk zëvendësohet brenda muajit por prapë kur del një arsimtarë që e lironë vendin e punës për aryeje personale duhet me zëvendësuar një mësues ose mësues tjetër kudo që i jipet mundësia që e ka ndonjë orë të lirë,kjo ishte pyetja ime edhe në mbledhjen kaluar.

Drejtoresha e Arsimit nuk është këtu,por të paktën nuk e kam parë asnjëherë prej se është emëruar Drejtoreshë e Arsimit këtu.Unë nuk e di se kush duhet me u marrë me këtëqështje,unë nuk e di a duhet me u marrë ne apo ju?Unë deshta me reaguat te transformimi i qytetit por e bëni si të pamundur me reaguat e përmendi z.Enveri për raportin e auditorit i cili tregonë se qfarë ke bërë dhe e dyta z.Hafir dëshirojë me ju pyetur por edhe juve si ekzekutiv se a kanë filluar hetuesia financiare me ju hetuar për dy projektet që i keni bërë në vlerën financiare prej pesëmbëdhjetë milion euro ose gjashtëmbëdhjetë euro e diçka?A ka filluar hetuesia financiare me i hetuar këto dy projekte?Sa e kam unë informatën dikunë kanë filluar me hetuesi.Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Imran.Fjalën e ka kërkuar z.Fitim Shala.Urdhëro.

Fitim Shala(anëtarë nga rradhët e partisë Lidhja Demokratike e Kosovës):I nderuar Kryesues i Kuvendit,të nderuar Drejtorë,kolegë Asambleistë,të nderuar media dhe qytetarë të Komunës tonë.Unë ju bashkangjitem të dy kolegëve Asambleistë edhe unë shprehi ngushllime ndaj familjes Berisha dhe të gjithë qytetarëve të Komunës tonë.Unë uroj dhe shpresoj që raste të tilla të mos ndodhin më kurrë në vendin tonë.Me qenëse Drejtori i Urbanizmit qenka prezentë,unë do të ngrisë

disa qështje që lidhen me investimet kapitale në Komunën tonë, rruga e "Rrafshit" në fshatin Ngucat para dy viteve ajo rrugë është bërë gati për asfaltë mirëpo ende nuk është bërë asfaltimi i asaj rruge, kjo është kërkesë e banorëve dhe pyetje direktë e tyre. Kërkojë nga Drejtori që të na tregojë se kur do të shtrohet kjo rrugë? Po ashtu është edhe rruga e vjetër në fshatin Ngucat e quajtur rruga e "Murgaqit" pothuajse gjysma e fushës e tokës bujqësore mbulohet në atë rrugë dhe është vështirë e kalueshme.

Një pyetje gjithashtu lidhet edhe me sigurinë e nxënësve përkatësishtë në lagjen Pintolli është pyetje e banorëve e di që Komuna e Malishevës përkatësishtë Drejtoria e Arsimit e bënë bartjen dhe transportin e nxënësve në disa fshatra të Komunës tonë, në atë lagje nuk bëhet bartja e nxënësve në atë shkollë kërkojë nga Ekzekutivi një sqarim për këtë lagje. Një problematikë e madhe është edhe qështja e ujësjellësit shumë qytetarë të Komunës tonë detyrohen të paguajnë faktura të mëdha të ujësjellësit e njëkohësishtë shërbimi që vie për atë fakturë nuk përkonë me njëra tjetrën.

Gjithashtu në fshatin Pagarushë përkatësishtë në afërsi të parkut të mullirit Islam Kryeziu kanalizimi i cili është vendosur nga Komuna para dy vite si pasojë e vërshimeve që ka ndodhur së fundi, ai kanalizim është shkatëruar dhe momentalishtë e paraqetë një pamje jo të mirë të atij parku dhe të atij mulliri që është renovuar nga Ministria dhe i njëjti është në mbrojtje si Trashigimi Kulturor.

Gjithashtu një qështje që paraqetë brengosje të banorët që janë në rrugën "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" në Malishevë aty janë duke ndodhur shumë shpeshë aksidente dhe është kërkesë e banorëve që në atë rrugë të vendosen police të vdekura në mënyrë që të redukohen rreziqet. Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Fitim. Me kaq po e përfundojmë deklaratimet jashtë rendit të ditës. Urdhëroni Ekzekutivi për përgjigje ndaj antarëve të Kuvendit. Fjalën e ka kërkuarë Drejtori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural z. Sylë Dukolli. Urdhëroni.

Sylë Dukolli (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural): Faleminderit Kryesus. Përsëndetje për të gjithë Asambleistë, Drejtorë, media, përfaqësues i OSBE-së. Unë dëshirojë të ndërlihem me fjalimin e znj. Valjeta dhe z. Enverin. Projektet janë të përbashkëta në mes të Komunës dhe organizatës Islamik Relief Kosova, realishtë ata e kanë pjesën më të madhe

të buxhetit nvaret prej kontraktuesit nganjëherë e kanë 73% të buxhetit. Pyetja se a janë bërë publike? Janë bërë publike.

Kush do që ka dashur me parë ka qenë aty te pjesa e hyrjes së Komunës, ne normalë që do ta publikojmë edhe pjesën e tjetër në faqen zyrtare të Komunës. Së pari ata punojmë për kategorinë e bujqëve të cilët dëshirojnë me pa me sy se a janë kategori e bujqëve apo jo. Kjo është metoda e atyre që vijnë dhe investojnë këtu. Pasi të përfundojë e gjithë procedura i publikojmë në faqen zyrtare. Ka pasur edhe ankesa prej qytetarëve në këtë rast prej bujqëve, mirëpo ata qytetarë që nuk kanë të mbjellur asgjë normal që nuk do të përfitojnë asnjëherë. Asambleisti z. Enveri tha që disa përfitues i shesin paisjet. Unë për veti nuk i kam parë. Ata i nxjerin të dhënat kompletë për dy vite atyre që ju kanë dhënë dhe nuk e përsërisin. Unë kam ankesa edhe prej kolegëve të mijë që nuk kanë përfituar, disa qytetarë në lagje kanë pasur edhe konfliktë mes vete për këtë punë unë nuk e kam dertë.

Për mua e rëndësishme është vetëm ata që punojnë në bujqësi. Kriteret për me aplikuar kanë qenë me i pasur dy hektarë të mbjellur grurë ose misër ose kultura të tjera që i përgjigjen për me përfituar një mekanizëm bujqësor. Kur jau qet këtu që personi i cili ka aplikuar nuk ka aplikim kjo i bie që në vitin 2025-të ai nuk ka pasur të mbjellur asgjë. Pjesa tjetër këta janë organizatë humanitare, kur është te kategoria e rasteve sociale ata nuk e lëshojnë i ndihmojnë familjeve me fëmijë jetima, kjo na ka vendosur edhe neve në lajthitje sepse dikush thotë që unë i kam njëzetë lopë, por ata kanë me ja shpërndarë seren atyre që kanë nevojë më shumë i ndajnë për ekonomi të vogëla familjare, kështu kanë vepruar dhe do të veprojnë. A do të vazhdojë me bashkëpunuar me organizata? Unë do të mundohem me bashkëpunuar aq sa keni interesë edhe ju.

Janë 92 persona që kanë përfituar janë ndarë 42 sera, 22 multikultivator, 18 spërkatëse, 10 prerëse do me thënë ne për këtë pjesën nëse më lejohet publikishtë me thënë i kemi afërsishtë tetëmbëdhjetë mijë euro ose nëntëmbëdhjetë mijë euro që kemi me i dhënë ne si Komunë ndërsa investimi llogaritet që shkonë afërsishtë një qind mijë euro.

Të jemi pak konkretë jo ai që nuk përfitonë menjëherë me reflektuarë. Te pjesa tjetër se po i bie me përsëritur që e tha z. Enveri dikush ka përfituar dy herë komisioni i ka me emër dhe mbiemër dhe kësaj here absolutikishtë unë ju kam thënë nuk e nënshkruajë derisa të ka komision ne e kemi një antarë të komisionit, në terren jam për pjesën e dytë që ju bashkangjitem ne mundemi gjithqka

me debatuar,ata që kanë aplikuar i kanë aparatuar e veta,rreth 600 veta kanë aplikuar vetëm 90 veta është dashur me i zgjedhur e di që ka me pasur gjithmonë interes dhe kërkesa të vazhdueshme.Sa ka ndikuar zhvillimi i bujqësisë?

Ai i cili merret me bujqësi i ka bërë vetë në fillim të gjitha aparaturat e veta,kjo është një ndihmë e cila e shtonë mundësin e rritjes së misrit,unë jam duke parë aplikimet që janë duke u bërë ndaj subvencioneve numri më i madh i hektarëve që po shtohet është pikërishtë misri për arsyeje që janë hjekur djerinat dhe lëndët e tjera dhe janë kthyer në toka bujqësore kjo është për admirim.Personalishtë nuk kam informatë se sa ka ndikuar dhënja e paisjeve në ndihmë për rritjen e zhvillimit të bujqësisë.Faleminderit nëse keni ende pyetje të tjera parashtroni.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit,nuk jemi në fazën e pyetjeve e vlerosoj shumë,këtu jemi në debat jashtë rendit të ditës për të deklaruar Asambleistët.por në këtë rast edhe te përgjigjja konkrete nga Ekzekutivi,tani nuk mund të bëhenë pyetjet dhe të jepen përgjigjet sepse mundet me pasur edhe raporte të veqanta në këtë rast të Drejtorit të Bujqësisë.Drejtori i Urbanizmit e ka kërkuar fjalën për interpretim të përgjithshëm te pyetja e cila u ngritë.

Avdi Morina(Drejtor i Urbanizmit):Faleminderit Kryesus.Përshëndetje Asambleistë,media, përfaqësues të shoqërisë civile.I ndëgjova pyetjet të cilat u parashtruanë nga disa Asambleistë edhe ne e dim gjendjen e cila është,mirëpo kjo nuk nëvaret vetëm prej dëshirës apo vullnetit tonë,janë shumë faktorë të tjerë të cilët ndikojnë është buxheti i cili është i kufizuar për ti plotësuar të gjitha kërkesat dhe nevojat e qytetarëve.E përmendin nuk po shkojë kështu me emra me cekur por vetëm si kërkesa po përgjigjem te qështjen e energjisë elektrike në Lagjen "Hil Mos"realishtë e vërteta është se ne i posedojmë shkresat që ju kemi drejtuar Kedsit në këtë rast se në lagjja e cila ka probleme në rrugën "Hil Mos" të zgjidhet sepse i kemi disa familje që me vite të tëra vuajnë me mungesë të energjisë elektrike,mirëpo absolutikisht Kedsit thotë që janë ZRE-ja është ajo që nuk po ju lejonë me bërë investimet e mëdhaja e ZRE-ja është institucion qeveritar dhe kjo nuk po i lejonë me bërë investime në vendbanime të caktuara dhe nuk kanë mundësi për të investuarë,kjo është e vërteta.Ju e dini që detyra e Komunës është vetëm për të kërkuarë me ju ofruar pak ndihmë qytetarëve sepse nuk ka kompetencë asgjë qka ka të bëjë me energji elektrike është përgjegjësi e Kedsit sepse ne dëshirojmë me investuarë por në këtë rast ne nuk guxojmë prej buxhetit me investuar sepse në këtë rast Kedsit është kompani private.

Te rruga "Ilaz Dragushi" jo vetëm tek kjo rrugë por edhe tek shumë rrugë të tjera ka nevojë për intervenim, rregullim në tani jemi në fazën e përgaditjes të procedurave në bazë të projekt buxhetit që janë votuar në Kuvendin Komunal, për afërsisht të parashihen mbi pesëdhjetë kilometra rrugë, në të gjitha lagjet dhe fshatra të Komunës së Malishevës, njëkohësisht edhe në qendër të Malishevës.

E përmendi dikush rrugën "Rrafshi" në e kemi kontaktuarë operatorin, me të vërtetë e kemi parë është një rritje e norme e qmimeve sipas operatorit mirëpo në qoftëse ka qenë pesëdhjetë kilometra në nivelin asfaltat tani është dyzetë e tre, ta keni si informacion se në fund të muajit priten të bien qmimet e asfaltit që ta asfalttojmë edhe atë rrugë e cila është e planifikuar, ndërsa rrugët e tjera që i përmende realisht jemi në fazën përgaditore për trajtimin dhe asfaltimin e rrugëve.

Diqka tjetër e cila u harua, unë e kam parë në rrjete sociale në facebook është qështja e rrugës në Tërpezë, Kleçkë dhe Luzhnicë të cilën një Asambleistë e ka postuar, sa për dijeni të Kuvendarit rruga është në përgjegjësi e Ministrisë e cila e ka marrë në mbikqyrje dhe mirëmbajtje për katër vite dhe që katër vite është e vërtetë që asnjë kaci nuk është investuarë në atë rrugë.

Veton Zogaj (anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje): A ka mundësi me na sjellur atë vendim?

Avdi Morina (Drejtor i Urbanizmit): Këtë vendim kërkoni nga Ministri z. Hysen Durmishi nëse dëshironi pyteni edhe z. Dimal Bashën. Ne kemi bërë kërkesë edhe për rrugën e cila fillonë nga fshati Lumishtë deri në fshatin Mrasorë është jashtëzakonisht një segmentë i gjatë me të cilën mundësia buxhetore e komunës nuk ka mundësi për me trajtuar kompletë atë rrugë. Ne kemi bërë kërkesën për shkakë që ajo rrugë i lidh katër komunat e lidh komunën e Malishevës me komunën e Gjakovës e Rahovecit dhe Klinën ne kemi kërkuarë që edhe ajo rrugë të meret në mbikqyrje sepse ajo është segment i gjatë dhe nuk ka mundësi financiare që me trajtuarë kompletë si tërësi këtë rrugë. Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit. A ka dikush me marrë fjalën nga Ekzekutivi. Fjalën e ka kërkuar znj. Valjeta Hoti.

Valjeta Hoti (anëtare nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës): Faleminderit Kryesues. Unë e kërkova fjalën sa ishte prezentë Drejtori i Bujqësisë këtu sepse unë nuk dëshirojë që me tingëlluar sikur unë nuk e dëshirojë apo nuk e dua të mirën e qytetarëve me qenë ajo që

është kundër bashkëpunimit të Komunës me organizata të ndryshme. E para e punës unë në fillim e ceka që e konsideroj që është e domosdoshme dhe e mirëseardhur dhe tjetra e kisha kërkuarë prej Drejtorit që me hyrë në faqen zyrtare të Komunës dhe me kontrolluar dhe me parë edhe vetë që postimet nuk janë bërë publike në faqen e Komunës edhe tjetra ne jemi këtu për të ngritur shqetësimet e qytetarëve qfarëdo forme që vijnë. A vijnë në formë të komenteve apo përmes emailit zyrtar nuk ka rëndësi, pyetjet e mija ishin shumë specifike dhe shumë të kjarta. A janë mundësit e barabarta dhe a po ndikojnë në rritjen e prodhimit bujqësor në komunën tonë? Përndryshe nuk patë nevojë që përgjigjet me i dhënë në atë qasje me atë tonë. Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit. Kalojmë me rendin e ditës. Para se me filluar me i pyetur antarët e Kuvendit se a kanë me shtuarë diçka për rendin e ditës. Unë i kam disa kërkesa të cilat kanë ardhur nga Ministria dhe zyra e Kryetarit. Kërkoj nga zyrtari ligjor që ti trajtojë këto kërkesa.

Muharrem Morina (zyrtar ligjor i Komunës së Malishevës): Faleminderit Kryesus. Përshëndetje antarë të Asamblesë, Drejtora, stafi mbështetës. Ligjërishtë unë nuk kam të drejtë me bërë propozime, kërkesa në Kuvend por vetëm të sqarojë ato kërkesa të cilat tani ju i keni përpara jush. Kërkesa e Kryetarit është që me kthy në rishqyrtim vendimin sipas shkresës zyrtare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal vendimi i cili është marrë në mbledhjen e kaluar për listën e pronave për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026-të. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal i ka kërkuar me i sqaruar edhe disa elemente të tjera, tani me listat e reja të Kryetarit me rishqyrtim të vendimit janë të sqaruara, ato kanë qëllim ndrim destinimin me sqaruar mirë dhe kjo është një formë e re që e kam punuar dhe të them të drejtën prej datës 24 deri në ditën e djeshme jam marrur me këtë problemë. Besoj që tani jemi në kuadër të kërkesës së Ministrisë së Pushtetit Lokal që është pjesë e kërkesës së Kryetarit aty e shpjegonë listën e pronave të veqantë dhe të përgjithshme.

Kërkesë tjetër është vendimi i Kuvendit në lidhje me Komitetin për Komunitete. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkonë që ky vendim të rishqyrtohet. Sqarimin se pse e kërkonë të rishqyrtohet është në pjesën e shkresës zyrtare të MAPL-së, besoj që edhe ju e keni para jush aty.

E kemi edhe kërkesën për rishqyrtim të komisionit për organizimin e zgjidhjeve nëpër bashkësi lokale kjo ka të bëjë kryesisht me zbatimin e udhëzimit administrativë qeverisës të Republikës së Kosovës dhe ligji për qështje gjinore ka kërkuar që qështja gjinore në këtë komision të përfshihet, besoj që edhe këtë kërkesë e kemi para jush, kërkesën e MAPL-së për rishqyrtim të këtij vendimit.

Kemi kërkesën e Kryetarit të Komunës që kërkonë që me shfuqizur një vendim të marë nga mandati i kaluar që ka të bëjë me hartat zonale. Nëse duhet mundem tani e sqarojë pse duhet me shfuqizuar nëse jo gjatë shqyrtimit të pikës mundem edhe më vonë.

Veton Zogaj (anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje): A mundesh me na sqaruar tani?

Muharrem Morina (zyrtar ligjor i Komunës së Malishevës): Ne e kemi pasur në Komitetin për Politikë dhe Financa së bashku me Drejtorin e Urbanizimit, Vetoni ka qeni i pranishëm ka qenë edhe një kërkesë e ardhur prej Drejtorisë së Urbanizimit nuk ka qenë mjaftueshëm e sqaruar me ju thënë të drejtën as vetë nuk e kam pasur të kajrtë se qfarë është duke u kërkuar, në ndër kohë kemi marrë informata prej Drejtorisë. Veton tani i kemi në fuqi planin zhvillimor i cili është miratuar në vitin 2019-të ai plan përfundonë në vitin 2027-të.

Hartat zonale dhe vendimi i cili është marrë paraprakë është konformë të planit zhvillimor që kanë qenë në fuqi që hartat zonale të jenë në harmoni me atë planë. Komuna e Malishevës ka filluar me pregaditur planin e ri zhvillimor e cila fillonë prej vitit 2028-të i cili është shtatë vite i bie deri në vitin 2035-të. Tani hartat zonale që i kemi inicuar me këtë vendim do me thënë bien ndesh me planin e ri sepse këto harta janë bërë me planin e vjetër.

Pasi ta bëjmë planin zhvillimor komunal ky Kuvend ka me marrë prapë të njejtin vendim ka me inicuarë procedurën për harta zonale por që kanë me qenë në harmoni me planin e ri zhvillimor e të cilën këtë plan kemi me pregaditur ju.

Me ju thënë të drejtën ai vendim për harta zonale nuk është kryer kurrë. Ne e kemi diskutuarë edhe në Komitet z. Veton ne e kemi marrë vendimin i kemi pregaditur hartat zonale i kemi dërguarë në Ministri, ata i kanë vonuar, pastaj ata e nxjerrshin një udhëzim të ri.

Hartat zonale që i kemi pregaditur ne kanë rënë në kundërshtim me udhëzimin e ri, prapë i kthejshin do me thënë nuk i kemi arritur kurrë hartat zonale sepse hartat zonale është vendim për procedura për hartimin e hartave zonale la keni të kjoartë jo për hartat zonale në zbatim.

Vendimin të cilën po e kërkojmë ne e gjithë ajo punë e cila është bërë kurrë nuk ka hyrë në fuqi. Këtë vendim ne po kërkojmë me shfuqizuar me filluar me planin zhvillimor, tani hartat zonale duhet me qenë në harmoni me planin e ri. Ky plan i ri ka me u punuar nga një grup i ekspertëve nga një kompani e jashtme e cila ka me sjellur draftin te ju pastaj ju keni me miratuar planin. Pas miratimit të planit ose të konfirmimit të Ministrisë së Mjedisit pastaj fillojmë me harta zonale të reja pastaj pas miratimit të hartave zonale fillojmë me planin rregullativ të qytetit dhe zonave të tjera që i përcaktonë komuna me harta zonale. Kjo është procedura, ky vendim është miratuar ka qenë në fuqi po asnjëherë nuk është zbatuar për shkakë që nuk kemi mundur me i përshtatë hartat zonale me udhëzimet e reja që janë nxjerrur vazhdimishtë me ndryshuar, nuk dëshirojë me thënë politikishtë që kjo Ministri e cila udhëheqet nga Lëvizja Vetëvendosje por edhe më herë e cila ka qenë e udhëhequr nga partitë e tjera të njejtat probleme i kemi pasur do me thënë ne nuk kemi mundur me shkuarë një hap me udhëzimet që i ka nxjerrur Ministria e Mjedisit. Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit përfaqësuesit të zyrës së Kryetarit. Atëherë i kemi katër pika të rendit të ditës që të jenë pjesë e rendit të ditës fillimisht, pastaj kalojë te antarët e Asamblesë Komunale. Propozimi im si Kryesus është këto pika: rishikim i vendimit për listën e pronave, rishikim i vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete, rishikim i vendimit për themelimin e komisionit për zgjedhjen e antarëve nëpër fshatra dhe kërkesa e Kryetarit për shfuqizimin e hartave zonale. Këto pika të rendit të ditës propozohenë të hyjnë në rendin e ditës si në vijimë si pika e 9, 10, 11 dhe 12-të.

Pastaj kalojë te antarët e Asamblesë Komunale a dikush ndonjë pikë tjetër. Fjalën e ka kërkuar z. Enver Hoti. Urdhëro.

Enver Hoti (anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës): Disa pika që kanë ardhur nga qveria, mund ti votojmë, mund ti trajtojmë ti inicojmë është krejt në rregullë. Unë kisha thënë mos me i vendosur të gjitha në një paketë siq jeni duke i nxjerrur ju nën një, nën dy unë e thash edhe në deklaram jashtë rendit të ditës mendoj që lista e cila është propozuar nga qeveria e komunës për dhënie dhe këmbim të pronave është mirë me u rishqyrtuar me u tërhjekur një

herë.Nëse ka një formë specifike le të na tregojnë jo në këtë formë masive.Jeni duke i hapur probleme njerëzve të cilët i kanë pasur ato haprisa në shfrytëzim me qindra vjetë,nuk jeni duke e rritur interesin publik e as zhvillimin ekonomik,ajo qfarë u tha me ndryshuar vendimin e vitit 2019- e planit komunal për hartat zonale për me ardhur deri aty,ju na keni sjellur vetëm një kopje të udhëzimit.A ka pasur kosto ai zhvillim i cili ka ndodhur deri më sot?A është punuar në atë planë, a është ndërtuarë ai planë pavarësishtë i cili nuk është miratuar?A është miratuar ai planë i zhvillimit komunal ndonjëherë?Ai vendim a ka hyrë në zbatim ndonjëherë?A ka kosto financiare?Ku ka mbetur ai intervenim deri tani?Ne nuk e kemi këtë punë.Unë nuk e di sa të holla janë shpenzuarë nëse është shfrytëzuar në lidhje me realizimin e atij vendimi?Pastaj sot është bukur vështirë me gjithë respektin e zyrtarit ligjor me folur për harta zonale.Ne e kemi një zhvillim të jashtëzakonshëm në fushën e infrastrukturës.E gjithë qështja është adresuar te pamundësia e kordinimit apo e bashkëpunimit me Ministrinë e Planifikimit Hapsinorë.Unë nuk do të marrë qëndrim që me mbrojtur nivelin qëndrorë dhe apo nivelin lokal.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Enver.Fjalën e ka z.Veton Zogaj.

Veton Zogaj(anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Faleminderit Kryesus.Ne si grup mendojmë që vendimi për harta zonale me u larguarë prej rendit të ditës sepse ne dëshirojmë sqarim na u tha që në KPF ska pasur fare vendim.Sot z.Muharremi tha që është ai vendimi.Pse dëshironi me bërë një punë kur ne e dim që ka pasur grupe punues të cilët kanë punuar një kohë të gjatë me harta zonale kanë bërë foto shumë aq sa kanë mundur.

Qfarë ka ndodhur pse po kërkohet me u shfuqizuar ai vendim?Me thënë se nuk ka ndodhur asgjë,me i mbyllur sytë.Ne e dim pse është duke u zvarritur e dim edhe prapa vijën e ksaj pse është duke dashur me u zvarritur kjo qështja e hartave zonale me bërë vetëm me planë zhvillimor me lejuar ndërtime kudo.

Kështu që ne kërkojmë me larguar prej rendit të ditës këtë pikë nëse gjejmë mbështetje.Për pikat e tjera jemi në rregull me i diskutuarë, mirë që i keni ndryshuar listën e pronave sepse këtë formë e kam kërkuar që sa kohë,mirë që e keni bërë z.Muharrem sepse është më e kjoartë.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor i Komunës së Malishevës):Ky vendim i cili po kërkohet për harta zonale,ta keni parasysh ky ka qenë për me i inicuar procedurat me i hartuar hartat zonale.Hartat zonale të cilat i kemi është e vërtetë që kanë punuar ekipet aty nuk do të duhej të

hiqen në shportë,por tani këto harta zonale kanë me u përshtatur me planin zhvillimor komunal për vitin 2028-të deri më 2035-të shtatë vite.Hartat zonale të cilat janë bërë në bazë të këtij vendimi nuk përputhen me një planë zhvillimor që kanë me u bërë për 2028-tën,por realishtë në vitin 2027-të kanë me filluar me proceduar për me u zbatuar.

Ndërsa i nderuar z.Enver plani zhvillimor komunal është inicuar në vitin 2012-të shtatë vite është punuar me atë në vitin 2019-të ka përfunduar nëse nuk gabojë ju keni qenë Kryesus i Kuvendit komunal në atë periudhë.

Enver Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës):Jo në vitin 2019-të nuk kam qenë pjesë e Asamblesë.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor i Komunës së Malishevës):Më falni pra.Unë po ju them që shtatë vite unë jam përplasur me Ministrinë ata kanë nxjerrur udhëzime ne kemi ndryshuar,Juendipia na ka ndihmuar me pregaditur planin zhvillimor sepse komunat e tjera i kanë dhënë me qindra mijëra euro për me pregaditur një planë të tillë.

Në vitin 2027-të është afati ligjor për planin zhvillimor,komuna ka me zbatuar,tani i mirë apo i keq gjendja e cila është paraqitur në terren nuk ka mundur as Drejtoria dhe askush tjetër me ndryshuar për shkakë dhe për me ja caktuar kushtet urbanistike dikujtë duhet me pasur hartën zonale dhe planë rregullativ,inizhinieri e dinë nëse i vendos kriter dikunë duhet me u bazuar në këto kritere.

Unë besoj që ky planë i ri i cili ka me u bërë ai do të bëhet në përputhje me ligjet dhe me udhëzimet e reja,pastaj kanë me u lëshuar hartat zonale ka me pasur debate publike sepse pa debatë as plani as hartat nuk kanë me u bërë.Pastaj plani rregullativ është për me rregulluar qështjen ashtu siq jemi duke kërkuar unë,ju edhe gjdo njeri i cili jetonë këtu sepse edhe ne jemi duke e parë se disa qështje nuk janë të qëndrueshme.Plani zhvillimor ka qenë në fuqi dhe ende është në fuqi.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit.Fjalën e ka z.Halil Morina.Urdhëro.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit shumë Kryesus.I patëm katër propozime prej jush,për pika shtesë te rendi i ditës, tri ishin të natyrës për rishqyrtim prej MAPL-së,zakonishtë kur ka kërkesë MAPL-ja për me i plotësuar apo me i rishqyrtuar vendimet të cilat i kemi marrë paraprakishtë kjo është e domosdoshme që me qenë

pjesë e rendit të ditës për me u trajtuar. Pika e katër është e vërtetë që ne e kemi trajtuar në KPF dhe kemi kërkuar informacione shtesë dhe në fundë kemi ardhur në konkluzionin që nëse ka një vendim paraprakë atëherë ne e vendosim gjatë seancës, nëse nuk ka ne e lojmë sepse ne nuk mundemi me votuar draftë sepse nëse drafti është votuar ai nuk është më draftë nëse nuk është votuar ai është draftë nuk ka nevojë me u shfuqizuar sepse nuk është votuar.

Kështu që ne në emër të grupit tonë këto katër pikat të propozuarë le të hyjnë në rendin e ditës edhe ti shqyrtojmë dhe pastaj ta hapim debatin për këto pika të rendit të ditës dhe të diskutojmë. Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Halil është shumë e vërtetë që kemi me diskutuarë gjërë e gjatë për këtë pikë të rendit të ditës dhe kemi ardhur në përfundim ashtu siq e keni potencuar nga grupi i Nismës sepse kemi pasur nevojë për një trajtim dhe një kërkesë ashtu siq e ka paraqitur Kryetari. Fjalën e ka kërkuar z. Enver Hoti pastaj z. Bashkim Krasniqi.

Enver Hoti (anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës): Kryesues është interesantë pse nuk vjenë Drejtori i Urbanizmit këtu për me na sqaruar këtë pikë sepse ai është kompetentë ngase Drejtorja e Urbanizmit është bartësi kryesor për hartimin e hartave zonale dhe ai do të duhej me qenë këtu për me na sqaruar pak më shumë. Unë në vitin 2019-të nuk kam qenë pjesë e Asamblesë ajo nuk ka rëndësi por e rëndësishme është vendimet që janë nxjerrur nga Kuvendi Komunal pse nuk janë zbatuar pse janë kaq shumë relacione në mes qeverisjes lokal dhe nivelit qendrorë. A do të ndodhë edhe në vitin 2028-të deri në vitin 2035-të kështu me ato harta zonale unë e kam ndrojtjen aty dhe prapë ndoshta do të kthehem në pikën zero dhe do të kenë nevojë për me ndryshuar vendime të tilla ata. Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Enver. Bashkim Krasniqi e ka kërkuar fjalën. Urdhëro.

Bashkim Krasniqi (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Faleminderit Kryesues. Të nderur koleg Asambleistë, të nderur Drejtorë. Në lidhje me pikat e rendit të ditës e sidomos me ato pika të cilat janë shtyer nga mbledhja e kaluar kemi kërkuar plotësim të dokumentacionit është mirë ju Kryesues dhe Komiteti për Politik dhe Financa me mbajtur një kontinuitet në mes të asaj që kthehet për plotësim do të thotë e me ardhur prapë në seancën e

rradhës për shkakë që pas një kohe ose nuk po vjenë ose po i humbë rëndësia e asaj dhe po i humbë kuptimi.

Kështu që unë po e shoh që këto pika që janë kthyer për plotësim normal unë e di që këto ka me i plotësuar dikush tjetër dhe jo ju Kryesus por të paktën nëse mundemi me na sqaruar që ju e keni bërë hapin e huaj me kërkuar sqarime nga departamentet përkatëse, normalë që këto pika të rendit të ditës që kanë ardhur kështu direktë në Kuvend sot që janë katër dhe ne i kemi vetëm tri dhe nuk e kemi vendimin që ka të bëjë për bashkësit lokale të paktën unë nuk e kam përpara vetës është mirë që këtë praktikë normalë unë mendojë që nesër ndoshta me i kthyer përgjigje MAPL-së ndoshta edhe ju e keni kohën e limituarë, nëse ka ardhur me kohë nga MAPL-ja ajo trajtohetë me kohë nga Komuna. Të paktën me na ardhur me kohë një ditë përpara përmes Komitetit ose me na ardhur një ditë ose dy përpara përmes emailit me parë se qfarë kemi me diskutuarë sepse po është ndoshta jo e pa kuptuarë por jo taman e kuartë që do me thënë ne me votuarë në fund. Plani zhvillimor dhe hartat zonale janë dokumentet më të rëndësishme që i ka Komuna. Unë besoj që do të merren seriozishtë këto dy dokumenta të punohenë dhe mos të ketë probleme për shembullë sikur ka pasur deri sot.

Nëse dikush dëshironë me ndërtuarë një fabrikë në fshat dhe nuk mundet me bërë ndrim destinimi dhe me ndërtuar aty pa leje. Kam pasur vetë rastë që kanë ardhur palët nuk kemi pasur mundësi as me vendim të Kuvendit me bërë ndrim destinimi dhe është dashur personi privat me ndërtuarë fabrikën pa leje fatëkeqësishtë për shkakë që nuk ka pasur planë zhvillimor që e ka paraparë zhvillimin në atë pjesë dhe normalë nuk ka as hartë zonale.

Një rast i ngjashëm është edhe kur një personë dëshironë me ndërtuarë një fabrikë për prodhimin e ujit dhe nuk lejohetë, ndërsa gjdo ditë ndërtohenë shtëpi, villa dhe nuk ka asnjë pengesë tjetër.

Ne duhet me bërë një planë zhvillimor një hartë zonale që do me thënë me ju bërë qytetarëve zgjidhje që në të ardhmen mos me pasur probleme. Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Bashkim Krasniqi. Unë kërkojë nga sekretaria e Kuvendit që të jetë më e angazhuarë përballë kërkesave sidomos kur bëhet fjalë për rishqyrtim, për shkakë se është dashur të përcjelllet tek të gjithë Asambleistët kërkesat që kanë ardhur nga MAPL-ja. Sa i përket trajtimit të kërkesave që janë shtyerë, unë kam kërkuarë nga departamenti i Drejtorisë për Gjeodezi me të cilën kam pritur deri në ora 3 deri në ditën e fundit

që kam pasur mundësi për me thirrur mbledhjen e Asamblesë Komunale. Ata vazhdimisht kanë pohuar se edhe një orë edhe një orë e përfundojna dhe nuk i kanë sjellur kërkesat. Unë e vlerësoj që trajtimi është dashur të përfundohet dhe të sjelletë në Asamble Komunale, por besoj që në mbledhjen tjetër i kanë të gatshme, por ka qenë qështja që unë nuk kam dashur me insistuarë në kuptimin që logjika i bie mos me menduarë që kur është te qështja e pronave është përgjegjësi e Kryesuesit ose i Bashkimit apo kujdo qoftë nga antarët e Asamblesë që të vie në pika të rendit të ditës.

Kërkojë nga Drejtoria e Gjeodezisë që të pregaditën dhe të sjellin me kohë materialin për trajtim. Atëherë meqenëse nuk ka propozime për rendin e ditës. Unë fillimishtë i kam këto katër propozime që i paraqita më herët. Kush është për që të futen në rendin e ditës?

Rezultati i votimit:

Për 16 vota.

Kundër 9 vota.

Abstenim 1 votë.

Miratohet propozimi me 16 vota për, që të futen në rend të ditës kërkesat që u parashtruanë më lartë.

E hedhi në votim rendin e ditës në tërsi kush është për?

Rezultati i votimit:

Për 16 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 10 vota.

Miratohet rendi i ditës me 16 vota për. Kështu fillojmë me rendin e ditës ashtu siq e kemi.

Pika 1

Pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e rregullt datë, 30.03.2026.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:A ka dikush për diskutim për procesëverbalin e hapi debatin?Meqenëse nuk ka me marrë fjalën e hedhi në votim kush është për?

Rezultati i votimit:

Për 24 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 0 vota.

Miratohet kjo pikë e rendit të ditës unanimishtë nga të gjithë të pranishmit.

Pika 2

Pika e dytë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të të hyrave dhe shpenzimeve janar-mars për vitin 2026.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Kërkojë nga Drejtori z.Blerim Thaçi që të bëjë një prezantim.

Blerim Thaçi(Drejtor për Ekonomi dhe Financa):Faleminderit Kryesues.Përshëndetje për të gjithë Asambleistë,Drejtor.Para juve do të prezantojë pasqyrat e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën e vitit fiskal 2026-të.Fillimishtë Komuna e Malishevës ka të miratur buxhetin për vitin 2026-të në shumën prej 22,088,710,00€ duke shtuar edhe këtë pjesën e donacioneve të vogla në shumën prej 1,141.78€ buxheti përfundimtarë është në shumën prej 22,089,851.78€.

Për këtë periudhë nga thesari i qendrorë janë alokuarë mjete në vlerë prej 11,606,543.16€ ndërsa janë shpenzuarë 7,807,764.87€ që si përqindje e kap vlerën në 67.00%.

Për vitin 2026-të janë të planifikuara të hyrat vetanake në shumën prej 1,943,948.00€.

Për tre mujorin e pare para juve janë të prezantuarë vetëm të hyrat e realizuara direktë nga komuna në shumën prej 192,091.64€ këtu janë të përfshirë periudha e TM1 të cilat arkëtohen gjobat nga gjyjata dhe gjobat nga trafiku.Para juve mundë të prezantojë që deri në ditën e sotme realizimi i të hyrave vetanake është rreth 500,000.00€ është një trend sikur vitin e kaluar jemi të kënaqur me të hyrat me qenëse për këtë vitë limit është më i madh në krahasim me vitin e kaluarë për rreth 500,000.00€ më shumë.

Dëshirojë të shtojë vetëm edhe një gjë pres pyetje edhe nga ju se si është bërë realizimi i shpenzimit,po ju prezantojë që në muajin mars kemi ekzekutiv të lëndëve përmbartimore në kuadër të kontratës kolektive të mësimëdhënësve kolektiv në vlerën prej 500,50.00€ dhe në muajin prill janë 85,000.00€ që si total sillen rreth 640,000.00€ të shpenzuara nga përmbartuesit te lëndët përmbartimore që janë shkaktuarë nga kontrata kolektive që ka ndikuar në realizimin e shpenzimeve në tre mujorin,do me thënë ka mjete të shpenzuara të pa planifikuara nga ne.Pra janë realizuarë nga thesari me vendime gjyqësore.Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit Drejtor.Hapi debatin për anëtarët e Asamblesë.Fjalën e ka kërkuarë znj.Valjeta Hoti.Urdhëro.

Valjeta Hoti(anëtare nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Faleminderit Kryesues.Drejtor unë do të ndalem direktë te projektet kapitale e kam një pyetje.Sa projekte janë realizuarë realishtë në këtë periudhën tre mujore,këtë periudhë jam duke e cekur për arsyeje se e pa kuptuarë për me kuptuarë se a po flitet për projektet që vetëm janë ndarë mjetet dhe në ndërkohë po pritet punimi i tyre apo njëkohësishtë janë ndarë mjetet dhe janë projekte reale në terren edhe pse janë shumë do ti përmendi vetëm disa prej tyre siq është ndërtimi i rrugëve,kanalizimi,ndriqimi,specifikishtë është rregullimi i oborrit të Komunës,renovimi i sallës së Kuvendit Komunal e keni shkollën në fshatin Turiak me 265,00.00€ është renovimi i rrugëve lokale Drenoc,Vërmicë dhe Carrallukë me 20,000.00€.Gjithashtu edhe një pyetje tjetër te tabela 7.5 është e cekur rregullimi i lumenjëve dhe shtretërit e lumenjëve a janë të ndara apo jemi duke folur për të njëjtën gjë?A janë dy gjëra shumë ndryshe për arsyeje sepse njërën e ki në shumën prej 500,000.00€ ndërsa tjetrën për rregullimin e lumenjëve e keni me zero euro.Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit znj.Valejta.Fjalën e ka kërkuarë Vlera Bytyqi.Urdhëro.

Vlera Bytyçi(anëtare nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Faleminderit Kryesues.Përshëndetje për të gjithë meqenëse sot do të diskutojmë për raportin e të hyrave dhe shpenzimeve në Komunën e Malishevës në tre mujorin e parë edhe unë i kam disa pyetje për Drejtorin.Unë i kam analizuarë më shumë shpenzimet dëshirojë me pyetur Drejtorin pse e ka këtë planë të shpenzimeve në administratë dhe personel ne e dimë që është bërë ngritja e pagave prej periudhës së muajit janar por pse është ky dyfishimë në rritje?

Pastaj te zyra e Kuvendit Komunal kemi një rritje për dallim nga tre mujori i viti të kaluar 2025 në vitin 2026-të përderisa tani jemi Asambleista më pak sesa në legjislacionin e kaluar.

Te infrastruktura dhe rrugët është e pritshme sepse shumica e buxhetit ka qenë i orientuar në atë drejtim,pastaj e kemi administratën e shëndetësisë unë personalishtë nuk kam parë shumë konkurse në shëndetësi kurse shpenzimet janë rritur nga tre mujori i vitit 2025-të deri në tre mujorin e vitit 2026-të.Shërbimet sociale janë rritur normal që dëshira e secilit prej neve është që të rriten zhvillimet sociale mirëpo dëshirojë me ditur a janë rritur numri i atyre që kanë përfituar apo është rritur shuma e atyre personave që janë përfitues të këtyre skemave.

Te administrata e arsimit parafillor të çerdheve përderisa në ato çerdhe të hyrat i keni të zvogëluara në krahasim me tre mujorin e vitit 2025-të me tre mujorin e vitit 2026-të pse janë rritur shpenzimet?Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit znj.Vlera.Fjalën e ka kërkuar z.Veton Zogaj.Urdhëro.

Veton Zogaj(anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Unë shkurtë do të flasë sepse te kategoria e shpenzimeve i përmendi kolegija Vlera.Unë i vërejta vetëm disa qështje te kategoria e të hyrave vetanake i keni disa rrënje në disa kategori të ndryshme prej vitit paraprakë përshembull te çertifikatat e kurorëzimit janë të përgjysmuara ma pak,taksat e tjera administrative nuk e di për cilat taksa po bëhet fjalë në vitin e kaluar kanë qenë 11,708.00€ kurse tani janë 4237.00€ do me thënë është më shumë se përgjysmim,pastaj e kemi tatimin në pronë 120,000.00€ kanë qenë në vitin 2025-të në periudhën e parë kurse tani janë 45,000.00€ do me thënë është shumë rrënje drastike edhe te ndrim destinimi i pronës 3468.00€ tani janë 2352.00€ ndoshta janë kategori më e theksuar që këtu nuk kemi inkasim në raport me vitin paraprakë pse ka ndodhur kjo me na dhënë një sqarim për këtë.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Veton Zogaj.Fjalën e ka kërkuarë z.Hafir Rexha.Urdhëro.

Hafir Rexha(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit Kryesus.Unë dëshirojë vetëm ta parashtojë një pyetje kur është shqyrtimi dhe miratimi i raportit a duhet miratuarë në Kuvend?Zakonishtë raportet vetëm shqyrtohenë,realishtë ne nuk i votojmë,kështu që kisha kërkuar që herën tjetër nga administrata gjatë përpilimit të rendit të ditës të jenë më të kjartë sepse realishtë qka nëse nuk miratohet.Ne nuk duhet me miratuarë këtë qështje.Faleminderit shumë.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Hafir.Fjalën e ka kërkuar z.Burim Paçarizi.Urdhëro.

Burim Paçarizi(anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Përshëndetje.Me qenëse e kemi prezentë Drejtorin këtu unë do të ndalem më shumë te qështja e shpenzimeve me të

cilën e përmendi edhe kolegja, unë vetëm e kam një pyetje të renovimi të objekteve të shkollave pse është shuma me zero, brenda këtyre tre muajve a nuk janë para parë asgjë për renovim të shkollave?

Duke e pasur parasysh që në shumicën e shkollave kemi shumë nevojë për me bërë shpenzime dhe me intervenuar aty. Pastaj tek të hyrat vetanake në mënyrë analitike dhe ndrim destinim i pronës është një ndryshim shumë i madh a nuk ka kërkesa?

Tani është duke u parë që taksa për leje ndërtimi është rritur nuk po përputhen njëra me tjetrën qka ka ndikuar këtu më shumë. Taska për një ndërim të pronarit të tokës edhe këtu e kemi një rrënjë nga viti i kaluar e përmendi edhe Vetoni taksat e tjera administrative për cilat taksa bëhet fjalën sepse nuk jemi duke e ditur.

Te participimi në çerdhe për qfarë bëhet fjalë prej cilave grande kemi marrur apo qka ka ndikuar që po vie kjo vlerë 30,000.00€? Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Burim. A është i interesuar dikush prej anëtarëve të Kuvendit me marrë fjalën? Atëherë nëse nuk ka me marrë fjalën ja kalojë Drejtorit për sqarim.

Blerim Thaçi (Drejtor për Ekonomi dhe Financa): Faleminderit. Znj. Valejta te qështja e realizimit të shpenzimeve të mejteve për projekte është fjala për realizimin që e kemi pasur në vitin e kaluar dhe zakonishtë të gjitha shpenzimet e kësaj periudhe janë bërë për projektet e kontraktuara dhe kryesishtë janë pjesë më e madhe te qështja e obligimeve që i kemi hyrë deri në vitin e ri. Ju e dini që buxheti është alokuar në muajin mars dhe kemi pasur probleme me nivelin qëndrorë nuk kemi pasur në muajin e dymbëdhjetë vetëm në muajin e dytë, kryesishtë realizimi i shpenzimit është bërë në muajin mars dhe mundem me thënë në gjysmën e muajit mars pas ekzekutimit të lëndëve përmbartimore dhe kryesishtë në projekte kapitale janë ekzekutuarë faza e parë e lëndëve përmbartimore.

Ndërsa në muajin prill i kemi shpenzimet te kategoria e mallrave dhe shërbimeve e cila edhe këtu na ka paraqitur probleme. Janë realizuarë të gjitha projektet kapitale të cilat janë rrugët, sheshi të cilën e kemi pasur obligim edhe lumi i cili është duke u rregulluarë kjo është ajo pjesa grandit që kemi fituarë prej performancës ajo shuma 600,000.00€ është realizuarë vitin e kaluarë, ndërsa këtë pjesën tjetër i kemi tani për këtë vitë shumë prej 500,000.00€ nga buxheti i Komunës i cili

është ekzekutuarë për shtratin e lumit jo për rregullim të lumenjëve ne nuk kemi pasur as punës të kryera as kontrata të kontraktuara për rregullimin e lumenjëve.

Pse janë rritur shpenzimet? Janë shumë faktorë njëra prej tyre është ekzekutimi i lëndëve përmbartimore që neve na ndikonë në rritjen e shpenzimeve, pastaj obligimet ato të cilat janë bartur nga viti i kaluar munden me lëvizur në atë krahasimin e periudhës së vitit 2025-të me tre mujorin e parë ose të dytë varësishtë nga obligimet të cilat janë bartur nga viti paraprakë.

Pjesa tjetër te lëndët përmbartimore ka ndikuarë me shpenzimin më të lartë në krahasim me vitin e kaluarë. Te kategoria e të hyrave që u parashtruanë nga Vetoni dhe nga Burimi te qështja e këtyre taksave të tjera nuk është gabim teknik por kur organizohet pagesa e një takse te zyrtarët shpeshë e bëjnë nga një kod tjetër që realizimi i shpenzimit bëhet për një shërbim por me kode të ndryshme, ajo do me thënë i përfshinë të gjitha dhe shihet si një realizim i të hyrave nga taksat e tjera.

Tatimi në pronë i cili ka qenë më i ulët ju e dini që në fillim të vitit kemi pasur probleme sepse është shtyer zbatimi i ligjit të cilën e ka nxjerrur Kuvendi i Republikës së Kosovës për ndryshimin e ligjit për tatimin në pronë deri në muajin qershor dhe kemi pasur probleme deri në muajin mars me sistem nga niveli qëndrorë për të kryerë disa obligime të cilat i kanë pasur qytetarët për tatimin në pronë dhe nuk ka pasur mundësi më shumë për të realizuarë, tani është në rregullë dhe ka filluarë me realizuarë të hyra vetanake.

Te qështja e lejeve mjedisore dhe ndrim destinim ajo është qështje e urbanizmit dhe drejtorisë për kadastër, ndoshta është bërë vitin e kaluarë ndrim destinimi e tani mundet të bëhet leja e ndërtimit nuk e di si është procedura mirëpo kjo është fakti që na e kemi paraqitur para juve se qfarë është realizuarë si e hyrë.

Te participimi i çerdheve secili prind participonë për fëmijën e tij në shumën prej 50€ dhe diferenca është nga numri i fëmijëve sa janë në çerdhe, por kryesishtë kanë probleme edhe administrata e çerdheve me sistem dhe nganjëherë bëjnë pagesa për periudhën tre mujore për fëmijën që e kanë në çerdhe dhe këtu është ajo lëvizja dhe ndryshimi i të hyrave. Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit Drejtor, besoj që është konsumuar edhe debati për këtë pikë të rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës.

Pika 3

Pika e tretë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të Kuvendit Komunal Malishevë për periudhën Janar- Tetor 2025

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Raportin e keni përpara a ka dikush nga antarët e Kuvendit me marrë fjalën lidhur me raportin për vitin 2025-të?Fjalën e ka kërkuarë z.Halil Morina.Urdhëro.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit edhe njëherë Kryesus.Ne raportin e kemi parë,ne atë raportë autoriteteve të legjislaturës së kaluarë përkatësishtë të vitit 2025-të meqenëse ka qenë vitë zgjedhor është mbajtur një numër më i vogël i mbledhjeve,mirëpo megjithatë ka qenë një vitë i suksesshëm me vendime shumë të rëndësishme e unë dëshirojë këtu të shprehi falenderim të veçantë legjislaturës së kaluarë jo vetëm për vitin 2025 por në përgjithësi të mandatit të kaluarë,meqenëse gjatë këtij mandati dhe të asaj qeverisjesë së legjislaturës së mandatit të kaluarë Malisheva ka pësuar ndryshim dhe transformim të jashtëzakonshëm historikë dhe ajo punë nuk do të ishte e mundur pa miratimin e antarëve të legjislaturës së kaluarë.Qyteti i Malishevës ka bërë veprim historik,janë liruare masovikishtë hapsirat publike diqka e cila nuk ka ndodhur asnjëherë në periudhën e pas luftës dhe në asnjë komunës të Republikës së Kosovës.

Qyteti është transformuarë totalishtë dhe kjo është meritë e legjislaturës së kaluarë dhe unë e shfrytëzova foltoren për këtë pikë të rendit të ditës thjeshtë me shprehë një falenderim të veçantë për antarët e Kuvendit apo legjislaturën të cilën e kemi lënë pas.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Halil Morina.Fjalën e ka kërkuar z.Veton Zogaj.Urdhëro.

Veton Zogaj(anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Te kjo pikë dëshirojë të ndërlihem shumë shkurtë në mbledhjen e KPF-së e vërejta që në vitin zgjedhor ka pasur më pak aktivitete Kuvendi Komunal, megjithatë shpresojë që kjo legjislaturë do ta përmbushë të gjithë agjenden e saj në bazë të planit që e ka paraparë kështu që nuk kam diqka tjetër me shtuar për këtë pikë.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Veton Zogaj.Fjalën e ka kërkuar z.Burim Paçarizi.Urdhëro.

Burim Paçarizi(anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Komunës):Përshëndetje edhe unë dëshirojë të falenderojë kolegët të cilët kanë qenë në mandatin e kaluar për punën të cilën e kanë bërë,vërehet që në vitin 2025-të ka pasur një fluks më të vogël të punës për shkak të vitit zgjedhor,mirëpo shpresojë që në këtë legjislaturë në këtë vitë do të rritet numri i mbajtjes së mbledhjeve sepse kërkesat të cilat kanë mbetur të mangëta për qytetarët të përfundohen në këtë legjislaturë brenda afatit kohorë të përcaktuarë.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Burim Paçarizi.Fjalën e ka kërkuar z.Hafir Rexha.Urdhëro.

Hafir Rexha(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit Kryesus.Pasi që tre parafolësit e mi e cekën që kanë qenë në legjislaturën e kaluarë,unë si një Asambleistë i ri dëshirojë vetëm me i falenderuar sepse sinqerishtë e kanë bërë një punë të mirë dhe uroj që edhe ne si legjislaturë e tanishme që jemi të kemi mundësi me i realizuarë të gjitha ato kërkesa dhe vendime të rëndësishme në interesë të qytetarëve tonë.Faleminderit shumë.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit shumë z.Hafir Rexha.A ka me marrë dikush fjalën nga anëtarët e Kuvendit.Atëherë nëse nuk ka dikush me marrë fjalën e hedhi në votim.Kush është për që të miratohet raporti i Kuvendit Komunal për vitin 2025-të?

Rezultati i votimit:

Për 23 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 0 vota.

Miratohet unanimishtë kjo pikë e rendit të ditës.

Pika 4

Pika e katër e rendit të ditës:Shqyrtimi dhe miratimi i planit lokal për iintegrim.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Për këtë pikë unë kërkojë mirëkuptim nga ana juaj.Unë kam kërkuar nga znj.Edona dhe nga përfaqësuesi tjetër që të paraqitet sot në seancë,znj.Edona është në pushim përfaqësuesi ka thënë sot nuk mundem asesi të vijë.Unë duke e pasur parasysh që

interesi i Komunës është që të kalojë ky raport në aspektin e performancës, kërkojë nga anëtarët e Kuvendit që ta analizojnë dhe ta votojnë.

Ndërsa në rastet e tjera kërkojë nga ekzekutivi dhe nga palët e treta në këtë rast që në asnjë rrethanë mos të vijnë raportet pa qenë prezentë për ta prezantuarë.

E hapi debatin për këtë pikë. Fjalën e ka kërkuarë z. Halil Morina. Urdhëro

Halil Morina (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Faleminderit edhe një herë Kryesues. Unë shkurtë do të ndërlihem, ju keni të drejtë Kryesues për atë që e thatë, do të ishte mirë që propozuesi i kësaj kërkesë me qenë prezentë këtu, meqenëse ky dokumentë i jep pikë në performancën e Komunës së Malishevës, përndryshe ne mos të humbim pikë për shkak të këtij dokumenti, unë kërkojë që ky dokumentë të miratohet edhe pse kemi të bëjmë me një planë për riintegrim për vitin 2026-të e tani jemi pothuajse në gjysmë të vitit do të ishte mirë sikur të na kishte ardhur më herët ky planë mirëpo prapë se prapë kjo është arsyeja e vetme që e potencova që votojë pro për këtë dokumentë. Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Halil. Fjalën e ka kërkuar z. Hafir Rexha. Urdhëro.

Hafir Rexha (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Faleminderit Kryesues. Dokumentin të cilën e sjellin këtu duhet bërë prezantimin dhe arsyetimin e atij dokumenti, por siq e tha edhe shefi i grupit parlamentarë z. Halili duke e pasur parasysh që ne mundemi me u penalizuarë në performancë ne i jepim mbështetje duke e llogaritur që gjysma e vitit shkojë dhe kostoja financiare e këtij projekti, ne nëqoftëse e votojmë apo nuk e votojmë ajo nuk shpenzohet.

Në seancën tjetër Kryesues kërkojë që me qenë më të sinqerët në të gjitha pikat. Plani duhet të prezantohet sepse ne duhet me qenë të informuarë se qfarë jemi duke bërë si Asambleistë dhe si qytetarë. Ne i jepim mbështetje kësaj rradhe, por herën e ardhshme me qenë të kompletuarë. Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Hafir Rexha. Fjalën e ka kërkuar znj. Valjeta Hoti. Urdhëro.

Valjeta Hoti(anëtare nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Faleminderit Kryesus.Unë pajtohem plotësisht me mendimin e parafolësve sepse është dashur me qenë prezentë personat përgjegjës këtu,për arsyeje se ata duhet dhe është dashur me na dhënë një shpjegim,një elaborim të këtij plani sepse në shikim të parë është shumë i pa kjartë,seriozishtë nëse nuk e keni lexuarë strategjinë kombëtare për riintegrimin e personave të riatdhesuar është e pamundur me kuptuarë në thelbë.

Ky planë përveq që është i rëndësishëm në kuadër të politikave sociale i ka edhe disa mangësi që unë dëshirojë me i përmendur.

Unë e konsideroj që këtij plani është dashur me i bashkangjitur edhe një përshkrim i detyrave dhe përgjegjësive që e ka zyra komunale për kthim dhe komunitete si dhe komisioni komunal për riintegrim e ceka që ky planë i ka disa mangësi e para objektivat ishin shumë të përgjithshme dhe e dyta nuk është e kjartë financimi i cili do të bëhet.

Te strategjia kombëtare theksohet për fondin për riintegrim po ashtu edhe për decentralizim të kompetencave sa i përket pushtetit dhe burimeve dhe thotë aty shumë mirë që buxheti do të planifikohet në buxhetet vjetore të komunës.Në bazë të kësaj komuna mbanë përgjegjësi të plotë për zbatimin e këtij plani dhe sigurimin e burimeve.

Në këtë rast si qëndrojmë ne në këtë aspektë dhe a rrezikonë ky planë të mbetet vetëm deklarativ?

Meqenëse nuk janë personat adekuatë nuk e di sa mundeni me ju përgjigjur këtyre pyetjeve,unë në fillim e ceka që ishte dashur me qenë prezentë personat adekuatë.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit znj.Valjeta Hoti.A ka dikush nga anëtarët e Kuvendit me marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës?E hedhi në votim këtë pikë të rendit të ditës,kush është për?

Rezultati i votimit:

Për 15 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 8 vota.

Miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika 5

Pika e pestë e rendit të ditës: Formimi i Këshillit Organizativ për kremtimin e 16 Qershorit , Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Përfaqësues nga zyra e Kryetarit nuk kemi por unë besoj formula ka qenë e njejtë edhe në të kaluarën që pesë subjekte politike janë: Kryetari i Komunës,tre përfaqësues nga Drejtori të ndryshme siq janë ajo e Arsimit,Shëndetësisë dhe përfaqësues të tjerë nga zyra e Kryetarit,një përfaqësues nga organizata e OVL-së së UÇK-së,një përfaqësues nga OJQ-ja dhe Kryesusi i Asamblesë Komunale.A jeni të pajtuarë që të jetë kjo përbërje?E hedhi në votimë kush është për?

Rezultati i votimit:

Për 24 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 0 vota.

Ndërsa përfaqësuesit e subjekteve politike i ftojë për propozime.Fjalën e ka kërkuar z.Halil Morina.Urdhëro.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit Kryesus.Për këtë komision nga partia Nisma Socialdemokrate e propozojë z.Skender Zogaj.

Burim Paçarizi(anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Ne Partia Demokratike e Kosovës e propozojmë z.Sami Hoti.

Fitim Shala(anëtarë nga rradhët e partisë Lidhja Demokratike e Kosovës):Ne partia Lidhja Demokratike e Kosovës e propozojmë znj.Xheneta Morina.

Vlera Bytyçi(anëtare nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Ne partia Lëvizja Vetëvendosje e propozojmë z.Arben Krasniqi.

Enver Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës):Unë propozojë z.Kastriot Berisha.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Atëherë ne i votojmë në një pako,pastaj e bashkangjesim edhe vendimin e Kryetarit para se me dërguar në MAPL.Propozimet u dhanë nga partitë politike dhe pjesa tjetër bashkangjitet nga zyra e Kryetarit,kështu bëhet në tërësi vendimi i cili është komisionë për kremtimin e 16 Qershorit.Kush është për?

Rezultati i votimit:

Për 24 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 0 vota.

Pika 6

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Ne i kemi disa kërkesa që i kanë parashtruarë disa qytetarë.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/49, datë: 02.03.2026 është parashtruarë nga z.Sadik Mazreku me të cilën shtëpia ju ka djegur,materialin e kemi.Unë propozojë që këto tri kërkesa ti vendosim në një pako si trajtim për kompenzim të dëmit material apo kompenzim për trajtim shëndetësor varësisht nga kërkesa e paraqitur.E hapi debatin për këtë pike të rendit të ditës.Fjalën e ka kërkuarë z.Halil Morina.Urdhëro.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Meqenëse tri kërkesa të qytetarëve të cilën i kemi këtu,janë të natyrave të ndryshme,të paktën njëra prej tyre është e natyrës së ndryshme është mirë me i diskutuarë të ndara dhe të analizojmë.Ne sigurishtë që ndjejmë keqardhje sa herë që ka dëme materiale për shkakë të zjarrit apo të qfarë do natyre tjetër,ne e kemi vullnetin e plotë që të ju dalim në ndihmë këtyre familjeve,mirëpo në anën tjetër duhet me i pasur parasyshë mjetet buxhetore që i kemi.

Prandaj unë paraprakishtë kërkojë prej Drejtorit për Buxhet dhe Financa me na dhënë një pasqyrim të kuartë se si është gjendja financiare e Komunës së Malishevës,ne gjithmonë kemi pasur dakordim nga legjislatura e kaluarë dhe asnjëherë nuk kemi bërë politikë më këto llojë raste e sidomos me rastet për sëmundje,jemi dakorduarë për një qmim të caktuarë dhe i kemi shtyer përpara mirëpo shumica e atyre vendimeve kanë pasur problem të zbatohenë për shkakë të mungesës së mjeteve financiare,ne e kemi vullnetin e madh për të ndihmuarë qytetarët,ne mundemi me marrë vendim me ja ndarë shumë prej 10,000.00€ ose 20,000.00€ mirëpo pala atje na falenderonë i pretë ato të holla,mirëpo ato të holla ndoshta nuk i dalim asnjëherë sepse nuk ka mjete.Do të ishte mirë që vullneti jonë me u përshtaturë me mundësit tona financiare,në mënyrë që kurrë sot vendosim me ja ndarë një shumë të caktuarë,brenda një periudhe të shkurtë e ajo shumë e caktuarë me i dalë qytetarit të Komunës së Malishevës dhe jo me prituri dy ose tri vite.Unë kërkojë mirëkuptimin e të gjithë anëtarëve të Kuvendit megjithëse e di që secili prej juve e ka vullnetin e mirë për rastet e fatëkeqësive apo rasteve të sëmundjeve për me ndarë sa më shumë mjete por vullneti jonë nuk mjaftonë vetëm por duhet me qenë edhe mundësit e tona financiare.Kështu që unë kërkojë prej Drejtorit të Financave me na treguarë kuartë se sa kemi mundësi me ndarë mjete për këto raste.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Halil Morina.Fjalën e ka kërkuarë z.Burim Paçarizi.Urdhëro.

Burim Paçarizi(anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Unë e përkrahu mendimin e z,Halilit që këto tri raste janë të ndryshme dhe shpresojë që tri rastet ti diskutojmë të ndara pasi

që kanë tematika të ndryshme, mirë që është edhe Drejtori i Financave këtu sepse ai na tregonë mundësinë se si e kemi gjendjen financiare që mos të përsëritet praktika e cila ka qenë në mandatin e kaluarë, me të cilën kemi pasur një lloj peshe të njëjtë të ndarjes për ata që kanë bërë kërkesa, në këto raste të mos bëjmë politikë asnjëra prej subjekteve politike por të shkojmë në bashkëpunim por e dimë që komuna jonë ka mangësi financimi dhe nuk ka mundësi me plotësuar kërkesën e të gjithë dëmit që ju ka shkaktuarë apo sëmundjes të cilën e ka personi, por shpresojë që në tematikën e njëjtë të vazhdojmë edhe në këtë mandatë që sa kemi mundësi me i ndihmuarë qytetarët e Malishevës. Drejtor na jep një përgjigje si i kemi mundësit financiare që mos të bëjmë politikë në këto raste të ndjeshme por të shkojmë me vlera të cilat kemi mundësi me i paguarë ata persona që kanë nevojë. Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Burim Paçarizi. Fjalën e ka kërkuar z. Hafir Rexha. Urdhëro.

Hafir Rexha (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Faleminderit Kryesues. Unë në rradhë të parë dëshiroj sqarim prej Kryesuesit të Kuvendit, me sa ne jemi në djeni dhe në bazë të legjislacionit në fuqi se të gjitha kërkesat të gjitha shpenzimet që bëhenë realizohen prej zyrës së Kryetarit. Ne e konsiderojmë që jemi një Komunë nuk ka paralele. Unë dëshiroj që kjo praktikë e cila është mos me vazhduarë sepse të gjitha kërkesat e qytetarëve të cilat kanë nevojë dhe janë plotësisht për me i mbështeturë sidomos rastet që janë me sëmundje të adresohenë te zyra e Kryetarit. Kryetari me mundësit e veta i ka dy mënyra për të paguarë njëherë e ka me një vlerë më të vogël dhe tjetrën në vlerën më të madhe. Në vlerën më të madhe e ka që vjen kërkesa prej zyrës së Kryetarit filtrohet në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe vjen pastaj trajtohet te ne, tani KPF-ja nuk mundet me marrë vendim sepse ajo është organë filtrues, organ rekomandues. Unë i kam parë vendime që KPF-ja i ka ndarë mjete ndonjë qytetari në shumën prej 500€, unë nuk e di mundem me qenë i gabuarë por kërkoj sqarim. Unë herën tjetër në qoftëse ka vendim Kuvendi që ja ka bartë vendimin KPF-së le të na sqaronë edhe unë e propozojë që këtë vendim duhet me shfuqizuarë në qoftëse ka sepse këtu po tërhiqenë dy paralele, ne nuk jemi dy komuna, ne jemi një komunë. Drejtor të gjitha shpenzimet a shkojnë prej zyrës së Kryetarit? Atëherë zyra e Kryetarit është organë që i sjellë tek ne dhe ne mos ti kemi dy adresa, plotësisht pajtojë me z. Paçarizin se është mëkat dhe mjerim me bërë politikë me këto lloj raste dhe nuk duhet me bërë politikë me njerëzit që kanë nevojë dhe më e keqja është sepse ne kemi dualizma këtu, nuk kemi nevojë.

Në qoftëse qytetari ka nevojë me mbështetur me mjete për trajtim shëndetësor në qoftëse ka mjete Kryetari, Drejtori atëherë e sjellë kërkesën në Kuvend ne e votojmë si Kuvend dhe brenda periudhës kohore i dalin mjete shpejtë dhe jo me vonësë sepse ka vendime që janë marrë dhe pas gjashtë mujave i kanë dalur mjetet apo më e keqja që ka ndodhur ka qenë që mjetet i kanë dalur pasi ka vdekur personi është mëkatë dhe mos të bëjmë politikë me këto gjëra. Faleminderit shumë.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Hafir por realishtë para se me dalur në foltore duhet me qenë i informuarë sepse Kuvendi Komunal e ka rregulloren e cila ka të bëjë me subvencionimin me të cilën është ndarë në mënyrë specifike me të cilën Komiteti për Politikë dhe Financa ka hapsirë me ndarë mjete deri në shumën e vlerës prej 500€, Zyera e Kryetari 1000€ dhe Kuvendi Komunal ka hapsirë në vlerën mbi 1000€ kjo është rregullore e Asamblesë Komonale e

cila është votuar, kështu që ju keni qenë në të kaluarën Drejtor dhe nuk ka rëndësi me ditur këtë gjë.

Hafir Rexha (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Nëse më keni ndëgjuar me vëmendje pyeta nëse ka rregullore. Atëherë nëse ka rregullore unë kisha propozuar që në seancën e ardhshme ose e sjelli me shkrim në KPF, ose e sjelli në Kuvend. Këtë rregullore është mirë me shfuqizuarë sepse për mendim tim është e gabuarë.

I nderuar kjo pikërisht është dualizëm, ju lutem gjejini një emëritim tjetër. Unë kam qenë tetë vite Asambleistë le të më ndihmojnë edhe shokët e tjerë për shembullë z. Enver Hoti i cili ka qenë Kryesues, KPF-ja a është organë vendim marrës apo organë rekomandues, shoku Enver më fal që jam duke ju pyetur në këtë mënyrë a ju ka ndodhur në të kaluarën kjo praktikë ndonjëherë kështu.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Ju lutem mos i trajtoni indicjet personale në debate publike në Asamble Komunale sepse ka ligje ka rregullore i referoheni vullnetit për shfuqizim Asambleja Komunale i ka 27 anëtarë me 14 vota për kalonë shfuqizohet nuk keni nevojë vullnetin individualë me paraqitur në Asamble Komunale. Fjalën e ka kërkuarë z. Enver Hoti. Urdhëro.

Enver Hoti (anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës): Kryesues fillimishtë dëshirojë me tërënjë një vërejtje pavarësishtë kush e votojë rendin e ditës ajo kalojë me shumicë votash dhe është mirë me vazhduarë sipas rendit të ditës, nuk besojë që ka nevojë edhe një herë brenda rendit ditës me bërë një ngatërrim kështu se a jemi duke i trajtuar të tri kërkesat kështu apo ndarasë. Unë mendoj që qytetari ka nevojë për mbështetje ne e kemi një kopje të kërkesës ai ka pësuar një djegje në shtëpi te kjo kërkesë është e bashkangjitur edhe raporti nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim kjo është dashur të trajtohet në Komitet për Politikë dhe Financa. Këtu nuk duhet me pyetur Drejtorin a ka mjete është dashur të diskutohet në mbledhjen e Kryetarit kur të ju shkonë kërkesa.

Unë i ftojë të gjithë kolegët pozitivë e opozitivë ta miratojnë kërkesën e z. Sadik Mazrekut për arsyeje se ajo ka ardhur e bashkangjitur me një raportë nga institucioni i Komunës i cili është Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, mejtet se ku i gjenë komuna është problemë i saj dhe jo problemë i joni se a ja jepion paret pas gjashtë muajve z. Hafiri nuk jam duke e ditur se a është duke e luajtur rolin e pozitës apo të opozitës apo edhe cilësinë e qytetarit, unë e respektojë shumë si kolegë mirëpo nuk mundet me bërë një dyfishimë të tillë,

Do të ishte mirë me qenë prezentë Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim me paraqitur rastin dhe të kërkojë prej neve që ne ta mbështesim rastin pastaj janë rrugët ligjore të cilat vijnë deri te realizimi me të cilën mundet me pasur një kohë të caktuarë përmbushja e vendimit. Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Enver Hoti. Fjalën e ka kërkuar Veton Zogaj. Urdhëro.

Veton Zogaj (anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje): Faleminderit Kryesues me qenëse jemi duke folur për kërkesën konkrete është mirë me qenë transparentë me kolegët këtu por edhe me qytetarët jashtë, zotëriu me të cilën ju ka shkakëtuarë dëmi ne në Komitet për Politikë dhe Financa ja kemi ndarë shumën e vlerës prej 500€ me të cilën nuk është pajtuarë me vendimin

e KPF-së dhe ka kërkuarë me shfuqizuarë atë vendim dhe ka kërkuarë që kërkesa e tij të paraqitet në Kuvendin Komunal me të cilën jemi duke e trajtuarë sot. Unë edhe në KPF kam kërkuarë që raportin të cilën e kanë bërë në terrenë djegia e cila i është shkaktuarë a ka bërë kërkesë shtesë te institucionet përkatëse në KEDS sepse me ditur shkaku sepse a ka ardhur deri te djegia e shtëpisë nga energjia elektrike apo ka qenë diegie e rastësishme ne duhet me pasur si informacion por si do që të jetë shkaktari ne të gjitha kërkesat që kanë ardhur në Kuvend nuk i kemi refuzuarë asnjëherë. Ndërsa sa i përketë qështjes tjetër z. Hafirit nëse ne kishim me bërë shkelje ligjore duhet ta keni parasysh që vendimet e KPF-së dhe Kuvendit filtrohen në MAPL dhe e kishin kthyer mbrapa secilin vendim nëse kishte pasur shkelje ligjore.

Mos të krijohet ky opinionë në publikë se ne veprojmë në krye në vete se nuk ka një vendim mbi të cilën thirrëmi. Ne e kemi rregulloren ju i keni numrat e votave nëse nuk pajtoheni me rregulloren sjelleni në Kuvend një rregullore të re kalojeni. Ne jemi një institucion që veprojmë në bazë të rregullores dhe ligjeve. Mos të krijohet në opinionë publikë një bindje se ne jemi një trup se kemi epërsi ndaj Kryetari që ai ndanë mejte dhe ne ndajmë mjete sepse ne nuk e bëjmë atë punë ne e kemi rregullorën dhe asnjëherë nuk i kemi kaluarë kompetencat pavarësishtë të qfarë natyre kanë ardhur.

Kryesus i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Veton. Fjalën e ka kërkuarë z. Halil Morina. Urdhëro.

Halil Morina (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Ne e kemi këtë rregullore nëse mendoni që diqka ka nevojë me ndryshuar e sjellim në rend të ditës dhe e ndryshojmë, rregullorja nuk është e pandryshueshme. Nëse ne e konsiderojmë që nuk duhet me ja deleguarë atë kompetencë KPF-së që me marrë vendime e anulojmë sepse ka situata konfuze që neve po na paraqesin para një gjendje jo të përshtatshme.

Nëse një kërkesë nga një qytetarë paraqitet te Kryetari apo Kryesusi i Kuvendit ne duhet me ditur gjendjen financiare që ne me shqyrtuarë dhe në të njëjtën kohë nëse nuk ka mundësi financiare është mirë mos me sjellur fare te ne.

Ne e dimë edhe në të kaluarën ne nuk i kemi subvencionuarë këto raste për me ju zgjedhur problemin por ne thejshhtë jemi solidarizuarë me ata, nëse dikushë ka vuajtur nga një sëmundje e rëndë ne i kemi ndarë në shumë prej 1000€ ose 1500€ ne nuk ja kemi zgjedhur hallin sepse nuk i kanë mjaftuarë për me trajtuarë kompletë sëmundjen por thjeshtë jemi solidarizuarë me atë.

Komuna e Malishevës nuk ka kapacitetë për me i mbuluarë të gjitha shpenzimet në rast se ndodhë ndonjë fatëkeqësi natyrore e njetë vlenë edhe për personin në fjalë me të cilën ju është djegur shtëpia, Komuna e Malishevës nuk ka mundësi me ja kompenzuarë dëmin në vlerë prej 15,000.00€ apo 20,000.00€. Unë nuk kam qenë në mbledhjen e kaluarë në KPF, por herën e ardhshme të gjitha kërkesat që vijnë kërkojë që të filtrohen mirë. Kërkojë prej Drejtorit të Financave me na treguarë sa kemi mundësi financiare për me mbështetë kërkesën e qytetarit që ju ka djegur shtëpia si dhe për dy kërkesat e tjera. Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Halil Morina. Fjalën e ka kërkuarë z. Hafir Rexha. Urdhëro.

Hafir Rexha(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Nëse me keni dëgjuar me vëmendje z.Veton unë isha shumë i kjarhtë unë nuk thashë që ju keni bërë shkelje unë vetëm pyeta a ka të drejtë apo jo, meqenëse është rregullorja gjdo gjë është në rregullë.Unë do të bëjë përpjekje që me sjellur në Kuvend atë rregullore dhe me ndryshuar.

Arsyeja që jam duke e thënë këtë është sepse do ta marrë shembullë kërkesën e personit që e ka bërë kërkesën për me i ndihmuarë sepse ju ka djegurë shtëpia ajo kërkesë është më se e nevojshme për me i ndihmuarë.

Mirëpo ju e keni larguarë dhe ja keni ndarrë mjetet në KPF kërkesës e cila është paraqitur me datën:25/02/2026 me numër të protokolit 02/44 me të cilën vuanë nga kanceri me shumën e vlerës prej 400€ keni vendosur për dy kërkesa dhe një e keni largurë po bëhet një lloj komplikimi në anën tjetër vitin e kaluarë në fshatin Panorc është djegur një shtëpi dhe në atë shtëpi është djegur edhe prindi i dëshmorit nuk ka ardhur kërkesa për subvencion në Kuvend por vetëm Kryetari e ka subvencionuarë për këtë arsyeje unë jam duke thënë që duhet me qenë filtrat shumë të fortë sepse me të vërtetë kjo është politikë.

Unë z.Enver me të vërtetë kur është rasti për qytetarin jam me qytetarin kur është rasti me pozitën jam me pozitën kur është rastin me opozitën jam me opozitën kur e ka mirë pse mos me duarë trokitë,unë i pëleqeje edhe kritikata e znj.Valjetës kur i ka me vendë edhe të z.Enverit dhe z.Vetonit kur bëhetë fjalë për të mirën e qytetarit.

Për rastin i cili bëhet fjalë qofsha i gabuarë por ky rastë është politikë sepse janë duke ndarë KPF-ja,zyra e Kryetari dhe Kuvendi të holla,nuk bëhetë kështu.

Kryesusi i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit.Fjalën e ka kërkuarë z.Enver Hoti.Urdhëro

Enver Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës):Ne e kemi obligim dokumentet të cilat i kemi ti trajtojmë.Unë mendoj që janë linjat buxhetore që bëhenë,dhe nuk është kompetentë Komiteti për Politikë dhe Financa me mbajtur linja të tilla sepse është ndërhyrje në buxhet dhe ndërhyrje mbi menaxhimin e financave institucionale,nuk keni nevojë me u thirur për rregullore dhe me u përplasur për rregullore se kush ka të drejtë më shumë në Kuvendin Komunl sepse është ligji mbi të gjitha dokumentet që ne i nxjerrim.

Të nderuar kolegë më vjem mirë që jemi duke diskutuarë sepse diskutimi është duke na nxjerrur edhe disa të meta të cilat janë duke na vendosur në binarrë për të funksionuarë si institucion.Prandajë ju kisha luturë që me qenë më kompetentë sepse janë burimet dhe mundësitë unë edhe njëherë jam duke qëndruarë pranë votës time,pavarësishtë që Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim nuk ka ardhur për të na dhënë një propozimë për me mbështetur këtë kërkesë.Unë tani e kuptova nga z.Vetoni që ju ka miratuarë një vendim nga KPF-ja që ja kanë ndarën shumën prej 500€,pastaj do të ndërlihem te z.Hafiri që mendonë se kjo është politikë mirëpo unë nuk mendojë që është duke u bërë politikë me të gjitha ato dëme të mëdha në shumën prej 20,000.00€ mirëpo kur Kryesusi i Kuvendit e hedh në votim këtë kërkesë unë do ta mbështesë pavarësishtë se me qfarë shume do ta mbështesim bashkëqytetarin tonë.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Më lejoni të ndajë një sqarim me juve,kjo kërkesë është mbështetur nga anëtarët e komisionit të KPF-së në shumën prej 500€,mirëpo parashtruesi i kërkesës ka thënë në qoftëse e vlerësoni që me më kompenzuarë në shumën prej 500€ mos mi ndani mjetet fare dhe ne e kemi anluarë atë vendim për shkakë që ka qenë e pa pranueshme prej palës.

Vitin e kaluarë kërkesat që i kemi sjellur në Asamble Komunale asnjëherë nuk ka pasur debate madje kanë kaluarë në mënyrë unanime apo po thuajse me shumicën e votave të anëtarëve të Asamblesë Komunale.

Këtu nuk jam për me bërë politikë,unë bëjë politikë me partnerët e kualicionit dhe nuk bëjë me anëtarët e Asamblesë,të gjitha veprimet që i ndërmarrë i bëjë në kordinimim me anëtarët e kualicionit,le të jemi të kjarhtë diskutimet të cilat i bëjë janë paraprakishtë të argumentuara prej qytetarëve kjo pikë e rendit të ditës ka ardhur specifikishtë prej zyrës së Kryetarit.

Ne kemi me pasur kërkesa të vazhduara në KPF,në zyrën e Kryetarit dhe në Asamble Komunale.Të diskutojmë gjërat me qetësi sepse kemi kohë këtu me diskutuarë deri në ora 20:00.Politikë bëjë vetëm me anëtarët e kualicionit.Fjalën e ka kërkuarë z.Veton Zogaj.Urdhëro.

Veton Zogaj(anëtarë nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje):Do të ndërlihem te fjalia e z.Hafir që tha është duke u bërë politikë,ne këtu jemi subjekte të ndryshme politike dhe është mirë me konkretizuarë kush është duke bërë politikë,pikërishtë për këtë kërkesë mirë që egzistojnë procesëverbalet.Unë kam kërkuarë prej palës me pyetur se a e ka paditur operatorin e KEDS-it nëse ju ka shkatuarë dëmi prej energjisë elektrike,le te sjellë padinë që e ka ngritur ndaj KEDS-it sepse shkakëtarë është ai pastaj ne i ndihmojmë këtu.Për secilën kërkesë unë z.Hafir jam njëri prej Asambleistëve që kërkesat kërkojë me i pasur edhe në email që mos me i hyrë në hak askujtë,ndërsa te qështja që e ngriti z.Enveri se i përketë ndeshmëri që mundet me pasur me ligjin për financat publike unë mendoj që nëse ne e kemi miratuarë në rregullore për subvencionim,në qoftëse në një nen e kemi theksuarë që KPF-ja ka të drejtë me ndarë mjete deri në shumën prej 500€ për këto lloj raste,kjo rregullore ka shkuarë në MAPL sikur të kishte pasur ndeshje ligjore MAPL-ja do ta kishte kthyr për rishqyrtim këtë vendim apo rregullore.

Sa i përket aspektit ligjor unë konsiderojë që është në rregullë.Por nëse dëshironi me bërë plotësim ndryshim në rregullore sjelleni në Kuvend sepse i keni votat e mjaftueshme për të kaluarë.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Veton Zogaj.Fjalën e ka kërkuarë z.Hafir Rexha.Urdhëro.

Hafir Rexha(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit Kryesus.Unë e kam një pyetje në bazë të informacioneve të z.Vetonit ju në KPF personit në fjalën i keni ndarë shumën e vlerës prej 500€,ju pohuatë që personi nuk është pajtuarë.Unë jam duke pyetur kërkesa e KPF-së prej kujt ka ardhur në Kuvend,a e ka sjellur pala apo kush e ka sjellur?

Pyetja ime konkrete është a e ka sjellur pala sepse ju ja keni dhënë një vendim në KPF me të cilën ja keni ndarë shumën e vlerës prej 500€,pala nuk është pajtuarë për këtë shumë.

A e ka sjellur pala kërkesën e re apo është kërkesa e njejtë qfarë ka ndodhur me ato 500€ atje dhe qfarë kemi me bërë ne tani këtu?

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Pala asnjëherë nuk ju drejtohet me kërkesë Asamblesë Komunale i drejtohet KPF-së.Fjalën e ka kërkuarë z.Bashkim Krasnqi.Urdhëro.

Bashkim Krasnqi(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit Kryesus.Unë mendoj që u sqarua sepse vendimi i KPS-së është shfuqizuarë sepse pala ka kërkuarë të trajtohet në Kuvend kjo qështje.Unë nuk pajtohem që të ndalen kërkesat sepse nuk është e logjikshme sepse dëme mundet me pasur vazhdimishtë por edhe sëmundje sepse është një dukuri e shpeshtë që paraqiten.Adresën kryesore qytetari i Malishevës e ka në Komunë dhe ne nëse ja mbyllim derën ku do të shkoj ai me gjetur mbështetje?Sa do që e vogël është ndihma që i jep Komuna ai e ndjenë mbështetjes që i jep Komuna.Unë pajtohem që me pasur një filtrim më të mirë para se me ardhur deri këtu mirëpo kur kërkesa të vie këtu debati me qenë i vogël ose mos me pasur debatë fare vetëm me u miratuarë.

Unë nuk e di kush e propozonë shumën për mbështetje,unë mendoj që është mirë me i mbështetur këto kërkesa për ndihmë financiare.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Bashkim Krasnqi.Fjalën ja kalojë Drejtorit për Ekonomi dhe Financa z.Blerim Thaçi.

Blerim Thaçi(Drejtor për Ekonomi dhe Financa):Faleminderit Kryesus.Fillimishtë për mos me hyrë shumë në diskutim rreth qështjes së rregullores në ligjshmërinë e MAPL-së,mirëpo ta keni parasyshë që autoriteti i vetëm për buxhet është zyra e Kryetarit të Komunës me të cilën gjdo vendim i tij ekzekutohet gjdo pagesë përmes Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa.E dyta z.Enver buxheti është miratuarë në muajin Janar për vitin 2026-të me të cilën janë caktuarë kategoria e subvencioneve,për vitin 2026-të janë 600,000.00€ të cilat janë të ndara për kategori të ndryshme.Unë pajtohem që janë qështje të ndjeshme që kërkohet solidaritet me ata por është kodi i cili subvenciononë zyra Kryetarit dhe Drejtoria e Shëndetësisë për me i mbështetur rastet që vuajnë nga sëmundjet,nëse e shfletoni raportin e buxhetit do ta vëreni sa mjete janë ndarë për këto raste në këto dy kode nga zyra e Kryetarit dhe Drejtoria e Shëndetësisë,ne kemi problemë me buxhet përveq lëndëve përmbartimore dhe te qështja e shpenzimeve sepse kemi rastin që me vendimin e juaj ne kemi subvencionuar leohat ne kemi probleme sepse ne nuk e përcaktojmë numrin e lindjeve ndodhë që shpenzohen deri në 100,000.00€ pra ne kemi subvencionim në lehona,në bujqësi,transportin e nxënësve,shpenzimet e varrimit dhe unë jam duke e theksuar që kemi probleme në inplementim sepse ne nuk e përcaktojmë numrin e lindjeve dhe as numrin e vdekjeve këtu lëvizë qështja e shpenzimeve janë të paparashikueshme numri i tyre ne nuk mundemi me përcaktuarë,ne mundemi me ja sjellur me shkrim në KPF sa fonde janë në dispozicionë për me u ndarë gjithashtu edhe juve në Kuvend mundemi me ja u sjellur,por meqenëse jemi në fillim të vitit kemi fonde dhe nuk jemi në fund të vitit që me thënë se nuk kemi mjete për këto tri kërkesa ju mundeni ti shqyrtoni nese miratohen ne i ekzekutojmë mjetet.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit Drejtor.Fjalën e ka kërkuarë z.Burim Paçarizi.Urdhëro.

Burim Paçarizi(anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Unë dëshiroj të ndërlihem shkurtë ne diskutuam me z.Halil dhe kolegët e tjerë,në legjislaturën e kaluarë ne kemi pasur një praktikë dhe po e them që nuk është mirë me bërë politikë për me këto raste.Unë pajtohem edhe me mendimin e z.Bashkimit sepse në këto raste Komuna duhet me i mikpritur për shkakë që ata derën e parë e kanë Kuvendin Komunal apo Komunën e Malishevës.Unë propozojë që praktika e njejtë me vazhduarë që për secilin rast që ka ardhur këtu ne e kemi mbështetur me shumën e vlerës prej 1500€,ne kemi menduarë që është ngarkesa më e ulët për buxhetin e Komunës

Ne kemi pasur një praktikë të mirë në mandatin e kaluarë dhe propozojë që të shkojë njejtë prapë,kërkesa e cila vie nga KPF-ja te ne nuk është e logjikshme me ndarë në shumën më të vogël se 1500€,prandajë të gjitha kërkesat që vijnë nga KPF-ja tek ne është mirë me i shtyrë përpara.Ne si Parti Demokratike e Kosovës në Malishevë ne i votojmë pro kërkesat ne jemi për me i ndihmuarë qytetarët.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Burim Paçarizi.Fjalën e ka kërkuarë z.Enver Hoti.

Enver Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës):Faleminderit Kryesus.Unë Drejtor ju ndëgjova me vëmendje,kërkesa është dashur të trajtohet në KPF para se me ardhur në Kuvend meqenëse ajo ka ardhur këtu ne do ta votojmë.

Ndërsa për qështjet e tjera që keni probleme me përmbaruesin neve nuk ka interesonë sepse unë mendoj që të gjitha burimet e përmbaruesit janë shpenzuarë nga planifikimet buxhetore sepse kjo është një temë tjetër dhe unë mendoj që duhet me pasur një ditë si pikë e rendit të ditës dhe me u merrë vetëm me këtë temë të përmbarimit me ditur se qfarë është duke ndodhur,pse janë duke ndodhur me na sjellur ju një raportë.

Vendimet e tjera të cilat mirren të zbatohenë të trajtohenë sepse është vetëm një qeveri,bashkëpunoni me Drejtorin e Shëndetësisë me Drejtorin për Mbrojtje dhe Shpëtim me juve si Drejtori për Financa dhe Ekonomi bashkëpunoni dhe kordinohuni në mes vete pastaj ejani këtu me argumente te ne për me i mbështetur.Qështja e përmbarimit duhet të flitet një ditë të veqantë për të.

Ne nëse mundemi me ju dhënë mbështetje qytetarëve kemi me ju dhënë mbështetje sepse kemi me mbrojtur interesin e komunës dhe të qytetarëve.Unë nuk e di pse kanë ndodhur këto ndërhyrje të përmbaruesit në buxhetin e komunës.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Enver Hoti.Fjalën e ka kërkuarë Halil Morina.Urdhëro

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Unë shkurtë do të flasë.Unë nuk e di a nuk jemi duke u kuptuarë apo nuk dëshironi me u kuptuarë meqenëse neve na kanë ardhur tri kërkesa këtë herë në këtë mënyrë,mirëpo herave të tjera duhet me u kuptuarë një herë e mirë në mënyrë që neve mos të naù përsëriten këto gjëra më.

Meqenëse kanë ardhur tri kërkesa por mos të krijohet ky procedantë për rastet e tjera, ne po vazhdojmë me praktikën siq e kemi pasur herën e kaluarë po i ndajmë nga 1500€ dhe mos të krijonë procedantë për rastet e tjera kurse në rastet e tjera duhet me i sqaruarë mirë sepse nuk duhet me u tallur me qytetarët e Malishevës.

Unë e di që vullneti i imi dhe i juaji është që me ja kompenzuarë të gjithë dëmi i cili ju ka shkaktuarë për shembullë nëse ju ka bërë 100,000.00€ me ja dhënë 100,000.00€ por tjetër është mundësitë financiare që ne i kemi.

Kështu që po vazhdojmë meqenëse jemi duke folur për një pikë konkrete, unë propozojë që me ja ndarë rastit në fjalë shumën prej 1500€, pastaj vazhdojmë me kërkesat e tjera.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Halil Morina.Fjalën ja kalojë Drejtorit për Ekonomi dhe Financa.

Blerim Thaçi(Drejtor për Ekonomi dhe Financa):Faleminderit Kryesus.Unë kam një përgjigje për z.Enver Hotin nuk ma merrë mendja që nuk jeni i informuarë për lëndët përmbartimore të paktën ju,sepse i gjithë oponioni kosovarë e dinë se prej nga janë duke ardhur lëndët përmbartimore,nuk ka pasur ditë që nuk është diskutuarë nëpër debate nga niveli komunal prej Kryetarëve dhe asosacioni i komunave që është duke u shkaktuarë nga kontrata kolektive dhe dëmet që janë shkaktuarë ne nuk mundemi me i sanuarë sepse neve nuk na lejohet me egzekutuarë kontratën kolektive për mësimëdhënësit.

Vitin e kaluarë që janë marrë lëndët përmbartimore te kategoria e subvencioneve ne kemi mbetur pa i paguarë deri në këtë vitë lehonat,nëse ka dikush ndonjë familjarë lehonë që kanë lindur në vitin 2025-të ne i kemi paguarë në këtë vitë në muajin mars për shkakë të lëndëve përmbartimore dhe jo për shkakë të financave por lëndë të kontratës kolektive.

Unë e thashë që jam për me i subvencionuar dhe vazhdojmë siq e tha z.Halili dhe z.Burimi vazhdojmë deri te një qështje që ju mundeni me marrë vendim në bazë të rregullorës.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit Drejtor.Para se me vazhduarë ende me këtë pikë të rendit të ditës,ta keni të kuartë që rendi i ditës pregaditet së bashku me Kryetarin dhe Kryesusin e Asamblesë Komunale edhe për këtë pikë të veqantë pala ka qenë te Kryetari dhe Kryetari e ka të adresuarë kërkesën në Asamble Komunale për shkakë që Kryetari nuk ka mundësi me i ndarë mjete më shumë se 1000€.

Të gjitha kërkesat që vijnë në Komunë janë të filtruara mirë ato janë te debatuarë mirë dhe pastaj vijnë në Asamble Komunale.Fjalën e ka kërkuarë z.Demir Bajra.Urdhëro.

Demir Bajra(anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Përshëndetje.Unë e ndëgjoja me vëmendje edhe pse kjo pikë është e ndjeshme dhe për këtë pikë nuk duhet me bërë politikë sepse kemi të bëjmë me raste që vuajnë me sëmundje dhe ne shprehim keqëardhje për të gjithë.

A jemi ne akterë për shembullë që me diriguarë qeverisjen komunale,a ka të holla apo jo ky nuk është problemi jonë,obligimi jonë është që ne me ngritur dorën për këta qytetarë që e kanë sjellur kërkesën në Kuvend qoftëse nëse ju ka djegur shtëpia apo vuajnë nga ndonjë sëmundje urojë që mos të kemi këto lloj kërkesa të shpeshta që vuajnë me sëmundjen e kancerit.

Unë mendoj që qeverisja komunale dhe Republika e Kosovës nuk është ajo e cila i lenë jashtë qytetarët dhe që nuk ka mirëqenie për ata sepse nuk i kemi gjërat keqë sepse trajtohen kërkesat sidomos rastet e personave që vuajnë nga kanceri.

Të jemi serioz,mos të bëjmë politikë për këtë pikë të rendit të ditës sepse në KPF i kemi përfaqësuesit tonë,qka kam me folur unë për KPF përderisa e kam përfaqësuesin politikë të partisë time aty edhe partia e Nismës e ka edhe partirë e tjera i kanë.

Kështu që ajo kalonë përmes Kryetarit në KPF pastaj vjenë në Asamble dhe se a do ta votojmë apo jo është qështje e jona personale se a dëshirojmë pra me ngritur dorën apo jo mos ta vonojmë këtë qështje për tri kërkesa që ishin paraqitur,për shembullë ndoshta nuk besojë që ne i kemi kompetencat qindë për qindë për me ditur sa është kërkesa.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Demir Bajra.Fjalën e ka kërkuarë z.Imran Xhyliqi.Urdhëro

Imran Xhyliqi(anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Faleminderit.Të gjithë jeni duke thënë se nuk duhet me ndalurë shumë në këtë pikë kurse më së shumti jemi ndalurë në këtë pikë.Ne jemi duke folur për raste të ndjeshme ndoshta do të kishte qenë mirë me qenë debati i fundit që jemi ndalur kaq gjatë në këtë pikë sepse me u ndalur në disa qështje që janë më të rëndësishme dhe më madhore atje jeni duke i mbyllur sytë,sikur të kishit debatuarë më shumë mes vete ju anëtarët e kualicionit do ti kishim punët më mirës sesa që jeni duke debatuarë me repelika më shumë se sa personit që ka nevojë me mbështetur për shkakë që ju ka djegur shtëpia.

E para thamë që shfuqizohet vendimi i KPF-së,ne në KPF e kemi votuar si pako këtë kërkesë të zotëriut në fjalë me tri kërkesa të tjera,nëse jam gabim besojë që janë edhe dy kolegët antëtarë të KPF-së,qka ndodhë nëse shfuqizohet për ato tri rastet e tjera.Faleminderit shumë.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Imran Xhyliqi.Nuk ka vendim pako por ka trajtim pastajë ka qenë vendimi në pako vetëm i shumës me të cilën është ndarë në propocionë të njejtë dhe e kemi votuarë nuk ka të bëjë asgjë,ne kemi folur për raste individuale dhe shuma ka qenë prej 450€.Vendimet janë individuale.Ju z.Imran nuk keni qenë në mbledhjen e fundit të KPF-së për vendimin që e kemi shfuqizuarë,vleresojeni situatën në mënyrë të vazhdueshme dhe jo vetëm aty kur jeni ju prezentë,jeni duke e diskutuarë qështjen duke pyetur ju se a keni qenë prezentë aty a ka ndodhur aty diqka dhe mendoni se prej aty është ndalur,jeta politike vazhdonë edhe pa këtë kualicionë,nesër meren veprime të tjera.

Ju nuk keni qenë në mbledhejen e fundit të KPF-së,ka qenë një vendim për shfuqizim i atij vendimi për ndarjen e mjeteve prej 500€ për kërkesën në fjalë.A isha i kjartë? Unë nuk do të duhej të mundoheja kaq shumë për me ju shpjeguarë kaq shumë fare,ju lutem.

E kemi një propozim të z.Halilit dhe z.Burimit që kërkesa të mbështetet në shumën prej 1500€.A ka dikush tjetër propozim?Kush është për këtë propozim të kërkesës në fjalë dhe në këtë shumë të propozuarë pa shkuarë te kërkesat e tjera?Kush është për që kërkesës në fjalë ti ndahet shuma prej 1500€?

Rezultati i votimit:

Për 25 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 1 votë.

Pika 7

Pika e shtatë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/50, datë: 03.03.2026.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Me ju thënë të drejtën unë nuk kisha dashur fare me kontestuarë.Kush është për që me ju ndarë shuma e vlerës prej 1500€?

Rezultati i votimit:

Për 25 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 1 votë.

Pika 8

Pika e tetë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/100, datë: 02.04.2026

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Kush është për që të ndahenë mjete në shumën e vlerës prej 1500€?

Rezultati i votimit:

Për 25 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 1 votë.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit,kalonë edhe kjo pikë e rendit të ditës urojmë që sa do pakë të ndihmojmë rastet që kanë nevojë dhe sa do pak të ju lehtësojmë dhimbjen atyre me të cilën jemi përballë rasteve të cilat janë të pa përballueshme për shërimin e tyre.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Kërkojë nga zyrtari ligjor për inkasimin që e ka bërë ose nga Drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër nëse është këtu për një interpretim.Drejtori nuk është këtu fjalën ja kalojë zyrtarit ligjor.Urdhëro.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor në Komunën e Malishevës):Faleminderit Kryesues.Unë edhe në fillim kur i paraqita kërkesat ju tregova pse ka kërkuar MAPL-ja rishqyrtimin e vendimit për listën e pronave e cila komuna planifikonë me i dhënë në vitin 2026-të ata kanë kërkuarë sqarime shtesë,udhëzimet ato janë të bazuara në ligje,ne kemi shkuarë me një procedurë Bashkimi ka qenë Drejtor i Gjeodezisë,përafërsishtë ne kemi shkuarë tri ose katër vite me listën shabllonë,tani i kanë kërkuarë disa sqarime shtesë për secilën pronë me ditur se cili është qëllimi i destinimit dhe kohëzgjatja,ne e kemi sqaruarë me aq sa kemi pasur mundësi.

Kërkesa e MAPL-së ka qenë e bazuarë në ligj në bazë të mundësive ne i kemi përshkruarë numrin e parcellës,sipërfaqën e pronësisë,destinimin,qëllimin dhe kohëzgjatjen.

Kohëzgjatja nëse e shikoni është në rubrikën e fundit është afatëgjatë pas vendimit të Asamblesë sepse ne nuk e dim se a do të ipet për dhjetë vite apo nëntëdhjetë e nëntë vjetë kjo nëvaret prej vendimit të Asamblesë se në qfarë periudhe kohore e vendosin kohëzgjatjen për dhënien e pronës në shfrytëzim.Këto janë sqarimet që i ka kërkuarë MAPL-ja dhe ne jemi munduarë me ju thënë të drejtën prej datës 24 deri në ditën e djeshme jam ballafaquarë me këtë punë,për shkakë se ka pasur shumë parcella dhe është dashur me shkuarë ndarasë për secilën.

Lista e parë është e veqantë dhe lista e dytë është e përgjithshme është lista e njejtë që kemi pasur më herët.Ne duhet me aprovuarë ndryshimin për shkakë se nëse nuk e aprovojmë ndryshimin,nënkuptonë që vendimi nuk kalonë.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Muharrem Morina.Fjalën e ka kërkuarë z.Demir Bajra.Urdhëro

Demir Bajra(anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Unë edhe mbledhjen e kaluarë kam kërkuarë,që parcellat me të cilën bëhetë fjalë ti shohim në ekran në mënyrë vizule dhe ta dim për cilën pronë jemi duke folur,po flasë në tërësi të Malishevës,qoftë në fshatin Panorc apo Llapqevë,Rud ta shohim që ne ta kemi më të kjashtë dhe me ditur për cilën parcellë jemi duke folur.

Do të ishte mirë me u njoftuarë ne mirë sepse me ja shpejguarë secilës palë se për cilën pronë bëhetë fjalë.Unë nuk e di pse është duke hezituarë pushteti kur ne kërkojë,unë nuk e kam fuqinë që ti them me gjdo kushtë o burrë i fortë publikojë në ekranë pronat me numër,sipërfaqe etj kjo qështje është e juaja.

Unë e konsiderojë që nuk është e qëlluar edhe herën e kaluarë e kam thënë sepse nuk është në rregullë gjërat që janë bërë nëpër fshatra,ju do ti vëreni më vonë pasojat sepse ka me vite të tëra që qytetarët kanë punuarë në atë pronë.Unë nuk kam asgjë personale ndaj atyre pronave por ju binduni që është një konfuzitet shumë i keq për shembull në fshatra me i prekut këto gjëra janë shumë të ndjeshme sepse ka qytetarë që nga gjenratë pas gjenerate e kanë punuarë tokën e kanë

trajtuarë pronën si të shejtë edhe sot përshembullë dikush na pushteti kush është iniciatorë që i ka marur këto parcella e dinë këta duhet me na dhënë në shpejgim sepse unë shprehi keqardhje për ata që tokën e punojnë që disa vite.Faleminderit.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor në Komunën e Malishevës):I nderuar janë qështje që në aparatën kadastrale e kanë pronësinë Kuvendi Komunal,nëse në teren ka ozurpime do me thënë ne nuk i dim.Nëse ndodhë që është e ozurpuarë ai duhet me vërtetuarë pronësinë në Gjykatë që ai është pronarë legjitim por për shkakë të kohës që e kemi kaluarë kanë mbetur në emër të Kuvendit Komunal këtë e vërtetonë Gjykata ne bazohemi vetëm te aparati kadastralë ashtu si është e rregjistruarë pronësia.

Ju e keni kopjet e planit dhe ju do të vendosni nëse dëshironi me jepur në shfrytëzim pronën,nuk është kjo përfundimtare.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Muharrem Morina.Fjalën e ka kërkuarë z.Enver Hoti.Urdhëro.

Enver Hoti(anëtarë nga rradhët e parties Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës):Unë edhe njëherë po e shprehi shqetësimin lidhur me vendimet që është duke i marrë Asambleja Komunale kompeltë lista e veqantë dhe lista e përgjithshme e cila është propozuarë mundem me përgjegjësi të plotë me thënë se as 10% e atyre sipërfaqeve nuk janë në interesë publik as të zhvillimit komunale dhe as të rritjes së vlerës së tyre.

Nëse jemi ardhur mbi tri komponente mbi bazën e të cilës duhet të merret një vendim për shpronësim apo për dhënie në shfrytëzim janë tri shtylla kryesore dhe në mesin e gjithë atyre propozimeve që janë me dhjetra apo qindar hektarë nuk i gjenë brenda atij propozimi të cilat i plotësojnë këto tri kushte.Fatëkeqësishtë prezentë e kemi vetëm Drejtorin e Urbanizmit dhe nuk janë prezentë Drejtorat e tjerë dhe kjo është një temë shumë e rëndësishme për qytetarët e Komunës së Malishevës.Komunat e përgjegjëshme i ruajnë haprisat publike dhe interesin publikë ne mendojmë të zhvillohemi,ne kemi nevojë me kriju haprisa sportive,hapsisa publike për qytetarët që gjeneratat e ardhshme me gjetur vetëm aty kurse ne sot me vetëdije të plotë po i konceptojmë te njerëzit e caktuarë të cilët mundë ti marrin,unë nuk kam fare interesë se kush mundet me përfiturë aty qoftë si individë apo biznes private subjekt afaristë.

Interesi i qytetarëve nuk është duke u mbrojtur,pronës nuk është duke ju shtuarë vlera.Ne gjithmonë kemi pasur kërkesa nga institucionet ligjore që duhet me i paraqitur listat e pronave në fillim apo në fundë të vitit nuk e di nëse ka ndonjë Komunë në Kosovë që ka arritur me përmbushë atë qfarë kanë kërkuar.

Për ju zyrtar ligjor z.Muharrem kam respektë permanentë ndaj juve ju keni obligime shumë me përgjegjësi por ju ngarkoheni edhe me pjesën politike e qmoj shumë vullnetin e juaj ndihmës që na jepni në aspektin profesional juridikë dhe administrativë.Për pronat që kërkohet me i dhënë në shfrytëzim afatëgjatë është jashtë ligji sepse propozimi duhet me qenë precizë kjo pronë i jepet për kaq vite ose i propozohet Kuvendit Komunal dhe jo për afatëgjatë sepse nuk e di si mundet ajo me qenë e njejtë për të gjithë ato pronat kur ndryshonë në qfarë konteksti .

Unë jam duke kërkuarë nga shumica e Asamblesë, Kryetari i Komunës nga qeverisja komunale që ta tërhejë atë hapë që ndërmarrë dhe të kthehenë në pikën zero dhe të na sjellë diqka konkrete ajo e cila është në interesin e qytetarve të Komunës së Malishevës për zhvillim ekonomik, për rritjen e vlerës të asaj prone dhe këto tri shtylla komponente ti trajtojmë sepse unë e di që pronat janë për me i shfrytëzuar ne përmes institucioneve dhe qytetarëve në këtë formë. Malisheva ka hapërisa të cilat mundën me rritur vlerës e asaj hapërsire kur flasë për Malishevën flasë edhe për të gjithë fshatrat. Unë nuk jam kundër që me kriju opinion te publiku mirëpo duhet me i veqarë ato ti trajtojmë me kujdesë me plane konkrete dhe jo kështu në formë masive.

Të gjitha hapësirat publike, fushat i keni nxjerur në shitje kjo është totalishtë e pa arsyeshme sipas meje dhe sipas asajë që e ndëgjojë vazhdimishtë tek qytetarët. Qytetarët kanë të drejta të mëdhaja, qytetarët kanë me qenë rezistencë përballë kësaj dhe unë si opozitarë do të qëndrojë në anën e tyre do të punojë natë e ditë 24 orë që këto me u kundërshtuarë edhe në forma të tjera si vendime ligjore. Unë do të jemë me ata që do ti përkrahu fuqishëm që me i kundërshtuarë. Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Enver Hoti. Para se me kaluarë fjalën më tutje tek të tjerët z. Muhremini është përfaqësues ligjor i Komunës për përgaditjen e shkresave dhe lëndës në këtë rastë, MAPL-ja nga ne ka kërkuarë trajtim dhe rishqyrtim dhe zyra e Kryetarit e ka bërë pikërishtë përmes zyrtarit ligjor. Fjalën e ka kërkuarë z. Halil Morina. Urdhëro

Halil Morina (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Në seancën e kaluarë e kemi miratuarë listën e pronave e tani MAPL-ja ka kërkuarë plotësimin e saj duke e detajizuarë secilën pronë me informacione shtesë. E vetnjja formë për me zhvilluarë ekonomikishtë një komunë është përdorimi i sajë për dhënie në shfrytëzim të pronës, e vetëmja mënyrë për me rritur vlerën e një prone është kjo formë. Prona e komunës egzistonë me qëllim që ne me rritur vlerën e saj, zhvillimin ekonomikë të komunës tonë.

Gjdo vend demokratikë që është sot i zhvilluarë është zhvilluarë me këtë formë shteti e ka tokën nuk i ka paratë, sektori privat e ka kapitalin do me thënë i ka paratë dhe bashkëpunimi mes këtyre dyjave kanë transformuarë vendin dhe i ka shëndruarë në vende të zhvilluara, sot ajo pjesa e mbarë e botës perendimore është zhvilluarë në këtë formë. Tani duhet me pasur të kuartë ne qka kemi votuarë në seancën e kaluarë dhe qka jemi duke bërë sot? A jemi duke e dhënë sot një pronë në shfrytëzim? Asnjë pronë nuk jemi duke e dhënë në shfrytëzim është obligim ligjor të rregullohetë lista paraprakte e të gjitha pronave të cilat janë të lira dhe të transformohenë në shfrytëzim, pastaj kur kjo listë të miratohetë, nëse ne për një pronë specifike kemi një kërkesë apo interesë të veqantë si komunë atëherë prapë ajo pronë vjen këtu nëse e merrë miratimin e Kuvendit formohet një komisionë dhe ai i zhvillonë procedurat e prapë ka me me ardhur me u votuarë për me u dhënë në shfrytëzim ajo pronë. Ne sot nuk mundemi me projedikuarë që nuk është interesi i komunës që me dhënë ndonjë pronë në shfrytëzim. Ku jemi duke e ditur që nuk është interesi i komunës? Kush jemi duke e ditur që ka me na ardhur në të ardhmen, ndonjë investitorë? Kështu ja rritë vlerën shumë asajë prone, kurse apriori me thënë tani se nuk është interesë i komunës me dhënë asnjë pronë në shfrytëzim, nuk rritet vlera e pronës në këtë formë. Ne kemi subjekte me ideologji të ndryshme, kemi parti të majta dhe të djathta e z. Enver Hoti i takonë një partie të djathtë siq është Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e fjalimi i tij kundër dhënies në shfrytëzim të pronës private edhe pse jenu ulur afër ulësve të Lëvizjes Vetëvendosje fjalimi i juaj po ngjanë shumë i anës së majtë dhe në

kuptimin që prona na duhet me mbetur në komunë e shfrytëzimi i pronës është nëse ne i ruajnë kooperativat e mëparshme e vetëm duke e mbajtur pronën na në pronësi e duke u munduarë ne vetë me mjetet e tona financiare me rritur vlerën e asaj prone ne e dim si kanë përfunduarë këto politika të majta në të kaluarën dhe ka pasur mjetë dështime të mëdha.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Halil Morina.Fjalën e ka kërkuarë z.Enver Hoti për replikë.Urdhëro.

Enver Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës):Faleminderit Kryesus.Së pari nuk qëndronë që unë e kam thënë që mos me dhënë asnjë pronë,unë e potencova shumë kjartë se janë dhënë me qindra ose pothuajse 90% të hapsirave publike në Malishevë të cilat ato lista janë këtu,mirëpo unë mendojë që ajo nuk është në rregullë.Unë edhe njëherë po e potencojë që a ka prona hapësira në Malishevë të cilat janë të nevojshme për me u shfrytëzuarë për zhvillimin institucional edhe për zhvillimin e kapaciteteve të biznesit, edhe në interesë të publikut.Miërpo duhet me pasur një planë hapsinorë,një planë i zhvillimit ekonomikë,ne e patëm më herët një pikë të rendit të ditës për harta zonale,a korespondojmë me të gjitha ato hapërisa,a ka Malisheva një planë të zhvillimit ekonomikë që ne mundemi me ja dhënë në shfrytëzim ndonjë biznesi?Ne jemi duke folur në bazën e ideologjive e zhvillimit të sistemit konceptualë të cilat jemi si parti politike majtas dhe djathas.Cilat janë ato mbështetje kur nuk e keni planin e zhvillimit për qytetë?Nuk i keni hartat zonale në rendin e parë as në rendin e dytë të qytetit,nuk jeni askundë me një planë rregullativ hapsinorë.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Enver Hoti.Fjalën ja kalojë z.Muharrem Morina.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor në Komunën e Malishevës):Kjo listë prej viti 2019-të publikohet është obligim ligjorë deri në datën 31.12 janë prona të lira të cilat komuna i ka ne nuk ka mundësi me i dhënë në shfrytëzim për vitin pasues,ne kemi dashur me publikuarë Asambleja nuk ka qenë e gatshme MAPL-ja na ka dhënë afatë jo vetëm neve por të gjitha komunave deri më datën:31Mars dhe me bërë publikimin e listës.Listën që ju e posedoni është publikuarë vazhdimishtë nga viti 2019-të.Ligji e specifikonë nenin i 13 ligji për dhënie në shfrytëzim të pronave publike thotë:publikimi i listës së pronave të palujshme të komunës,komuna duhet të publikonë listën e përgjithshme të pronave të palujshme dhe listën e pronave të veqanta që palnifikohenë për dhënie në shfrytëzim në vitin fiskal deri më 32 Dhjetor duke e arsyetuarë interesin publikë dhe zhvillimin ekonomikë të komunës,paragrafi 2 lista e pronave të palujshme për dhënie në shfrytëzim duhet të përmbajë këto të dhëna:të dhënat kadastrale të pronës,qëllimin,datën e publikimit të njoftimit për periudhën kohore për dhënie në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës.Kjo është lista e tërsishme nëse e shohim investitorët këtë listën dhe shohin interes e veta për me investuarë e sjellin një kërkesë dhe ajo kërkesë ka me ardhur dhe me u trajtuarë prapë,pastaj ju keni me vlerësuarë a ja vlenë komuna me dhënë.

Kjo është një listë e cila ka me u publikuarë për vitin 2026-të dhe nvaret prej palëve të interesit a munden me aplikuarë dhe a është interesi i tyre me investuarë në këto prona,mirëpo për këtë ka me ardhur një vendim në Asamble dhe ka me u shpallurë interesi publikë dhe ajo ka me u vlerësuarë nga ju,pastaj duhet me u konfirmuarë ligjshmëria nga MAPL-ja dhe është Kryetari i Komunës që e nënshkruanë kontratën.Në kontratë shkruanë kjartë nëse pala e interesit operatori

ekonomikë ose personi fizikë nuk investonë në bazë të planit të cilën e ka fituarë të drejtën me marrë këtë pronë i ndërpritet kontrata brenda afatit 24 muajë, kjo pronë është në shfrytëzim me qira nuk është pronë që shitet dhe pronësia mbetet 100% e Kuvendit Komunal në Malishevë asnjëherë nuk ndryshonë dhe nuk ka ligjë që e lejonë me shitur pronën publike në këtë rast të Komunës së Malishevës. Aspekti ligjor është qështje e imja kurse në aspektin politikë është qështje e juaj nëse e votoni apo jo. Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Muharrem Morina. Fjalën e ka kërkuarë z. Burim Paçarizi. Urdhëro.

Burim Paçarizi (anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës): Së pari është një fat i madh që Komuna e Malishevës ka një listë të gjerë të pronësisë, mirëpo ne si Parti Demokratike i kemi dhënë vërejtjet tona edhe në seancën e kaluarë për mënyrën dhe llojin e pronës për të cilat komuna dëshironë me i dhënë në shfrytëzim është edhe një fat i madh që prona janë në qendër të qytetit por edhe në periferi siq është edhe zona kadastrale në fshatin Dragobil e cila është fqinje me zonën në qendër të qytetit prandaj. Në komuna të tjera ka që detyrohen me blerë prona me të cilën nuk kanë prona në pronësi të tyre në qendër të saj ata detyrohen me dhënë shumë para për me blerë që me pasur në pronësi të vetë prona të ndryshme që të jenë në institucion të komunës.

Ne këtë potencial e posedojmë dhe komuna ka prona jashtëzakonishtë me vlerë dhe në të ardhmen pasi të realizohet një plan i mirëfilltë zhvillimorë komunalë urbanistikë me ju dhënë mundësinë që këto hapësira të shfrytëzohen në kuadër të Kuvendit Komunal, mos të nxitohemi ne vetëm ti vendosim këto prona pa e pasur një strategji të mirëfilltë, mirë është që plani zhvillimorë komunal është me afatë dhjetë vjeqarë ose pesë vjeqarë nëvaret prej ligjit. Në momentin që nxjerret një hapërisë publike e që ipet në shfrytëzim aty është mirë me u dhënë minimumi për tridhjetë vite dhe këto vite janë jashtëzakonishtë të mëdhaja që me pasur mundësi me u zhvilluarë ajo hapërsirë në shërbim të komuniteteve. Zakonishtë një planë i biznesit bëhetë mbi 30 vite afatet përcaktohen edhe me ligjë. Unë mendoj që është hap i madh që këto prona i kemi në pronësi të Kuvendit Komunal. Kryetari i Komunës nuk qenka këtu por besoj që ai i merrë informatat që parcelat që janë qendër të qytetit dhe ato të cialt janë në vende fqinje në zona kadastrale siq janë: Dragobili, Mirusha, Banja le të kemi kujdes me mënyrën se si dëshirojmë me i zhvilluarë në të ardhmen, besoj që ka me vazhduar ende strategjia për zhvillimin e qytetit që për dhjetë apo njëzet vitet e ardhshme të korespondojë edhe me parcelat e tjera sepse një ekip profesionale në rendin e parë merret me listën e pronave të komunës, targeti kompeltë i zhvillimit të qytetit shkonë me mënyrën se si me realizuarë së pari merret me atë pjesën ku nuk ka paguarë para komuna, me blerë komuna dhe ato hapësira përfitohen që me pasur hapërsirë për me u zhvilluarë qyteti, prandaj ne i kemi këto mundësi mos ti humbasim, mos ti jepim ndonjërit këto parcella për pak para e pastaj me ja blerë sepse është kosto shtesë. Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit z. Burim Paçarizi. Fjalën e ka kërkuarë z. Remzi Hoti. Urdhëro.

Remzi Hoti (anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate): Përshëndejte Kryesues dhe ju të pranishëm. Unë do të ndërlihem te pronat në fshatin Carrallukë përshembullë pothuajse në gjysmën e Carrallukës janë ndërtuarë shtëpi në llojëri jam duke u shprehur në gjuhën popullore dhe është mirë me vendosur këtu një tabelë në ekranë me ditur qka me votuarë, cilat prona janë

sepse është qështje e ndjeshme sepse i kanë investuarë qytetarët me miliona në ato prona përshembull Bajram Hoti nga fshati Carrallukë i ka të ndërtuara katër shtëpi në kohën e ish Malush Zhvani të cilin ashtu e quajnë dhe ato prona mbesin pengë,mirë është me i specifikuarë ky është mendimi im.Të drejtë e votës e kanë si pozita ashtu edhe opozita,unë kam votuarë pro mirëpo është mirë me ditur qka jemi duke votuarë.Në fshatin Carrallukë mbi 50% i kanë shtëpijat e ndërtuara në llongeritani nesër ne mundemi me hyrë në konfliktë me qytetarët me votën tonë dhe nesër mundemi mos me qenë në Asamble mundemi mos me qenë fare pejsë e politikës.Do të ishte mirë z.Muharrem me gjithë ju si jurist me pasur kujdes sepse ju e keni përpiluarë.

Muharrem Morina(zyrтар ligjor në Komunën e Malishevës):Drejtoria e Gjeodezisë e ka përpiluarë.Unë vetëm përshkrimin e kam bërë.

Remzi Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Unë Drejtorin e Gjeodezisë ende nuk jau kam parë këtu.

Muharrem Morina(zyrтар ligjor në Komunën e Malishevës):Do ta takoni edhe ai do të vijë këtu por ka pasur një rast në familje.

Remzi Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Do të ishte mirë me ditur cilat prona duhet me i votuarë,unë jam duke u nisur nga fshati im Carrallukë e kemi pronën te shkolla që e ka dhënë AKP-ja dhe sot kemi probleme.

Muharrem Morina(zyrтар ligjor në Komunën e Malishevës):Komuna nuk është titullare e asaj prone ajo është qështje e AKP-së me palë private.

Remzi Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Për punën e pronave ne duhet me ditur qka jemi duke votuarë sepse janë interesat e Komunës së Malishevës dhe unë nuk jam kundër sepse jam duke ardhur nga ky vend dhe kam dëshirë me ditur cila pronë ka me dalur për shfrytëzim.

Muharrem Morina(zyrтар ligjor në Komunën e Malishevës):Ky është një planë i tërsishëm pastaj keni me marrur për secilën.

Remzi Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Unë jam duke folur vetëm nga ai fshat i cili vijë dhe jo për qytetin, por ka probleme shumë të mëdhaja dhe ne me votën tonë duke e pasur parasyshtë që me votën e tyre unë jam këtu nuk dëshirojë me i futur në konflikte sepse unë kam shqetësimi për këtë qështje.E kam edhe një pyetje disa zallë ma kanë shtruarë në rrugë që ka mundësi me ma hjekur ose me shtruarë rrugë?

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Ju e keni ngritur një qështje e cila është obligim i Drejtorisë së Pronës dhe e Inspektoriatit.Fjalën e ka kërkuarë zEnver Hoti.Urdhëro

Enver Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës):E kam një pyetje z.Muharrem qfarë do të bëhet me këto lista paraprake?

Muharrem Morina(zyrtar ligjor në Komunën e Malishevës):Të njejta janë vetëm janë rifreskuarë,vazhdimishtë është e njejta listë.

Enver Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës):Për mua është një ndërmajre bukur e rrezikshme për zhvillimin e ardhshëm,ky është vetëm shqetësimi im.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor në Komunën e Malishevës):Me qenë në rrezik MAPL-ja nuk na lejonë me shku më tutje z.Enver.Ne nuk jemi duke bërë diçka të jashtëligjshme.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit.Fjalën e ka kërkuarë z.Bashkim Krasniqi.Urdhëro.

Bashkim Krasniqi(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Ne e kemi diskutuar edhe në mbledhjen e kaluarë me të cilën është një planifikim dhe në këtë momentë ne nuk e jepim asnjë pronë në shfrytëzim,kemi filluar me pesëdhjetë prona si vitë fillestarë kur ka hyrë në fuqi ligji në vitin 2019 që komuna me bërë një planifikim paraprakë për pronat publike dhe pastaj me i dhënë në shfrytëzim,ka shkuarë duke u rritur numri i parcellave gjdo vitë për shkakë që me i përfshirë të gjithë ato pronat.Ligji e parashehë që do me thënë të miratohen në parim lista e pronave që bëhet publike pastaj janë nën kritere të tjera do me thënë Kryetari i Komunës sipas ligjit për dhënie në shfrytëzim e bënë kërkesën dhe ja paraqetë Asamblesë se cilën pronë dëshironë me dhënë në shfrytëzim dhe cili është qëllimi.

I kemi nën kriteret e tjera që janë për dhënie në shfrytëzim të pronës dhe njëri prej kriterëve thotë të jenë i lirë ndaj obligimeve ndaj palëve të treta ky është kriteri të mos ketë ndonjë kontekst pronësor,do me thënë nëse në një pronë ka obligim pala e tretë ose ofrohenë prova që është në kontekst që do me thënë nëse është bërë ndërtimi pa leje në tokën publike,atëherë normal që komuna nuk besoj që do ta trajtojë atë si kërkesë që me dhënë në shfrytëzim,komuna nuk është për me nxitur konflikte,por rasti tjetër që komuna mundet me qenë në favorë të qytetarëve është kur një qytetarë e shfrytëzon që një kohë të gjatë tokën për qëllime bujqësore.Pse për shembullë ai mos me marrë edhe një kontratë prej komunës?

Po supozojmë për dyzetë vjet dhe prej asaj prone me i marrë edhe subvencionet për shkakë që e ka një kontratë,nuk mundet me lënë pa subvencion pronën publike për atë tokë që ka mbjellur grurë ose misër.Ta mendojmë anën pozitive pa një planifikim nuk jemi duke bërë asgjë do me thënë nuk jemi duke e dhënë asnjë pronë në shfrytëzim është një planifikim i cili është mirë me u miratuarë ashtu siq e miartojnë edhe komunat e tjera.

Sa ma shumë që ka prona komuna aq më mirë është që lista me qenë e pasuruar,ndërsa brenda kësaj liste ka prona që edhe me ja falur nuk e merrë dhe lërë më me zhvilluarë procedura këtu në Kuvend dhe me vendosur tarifa në baza vejtore.Kështu që unë nuk e di pse është kaq e komplikuarë për me kuptuarë,e miratojmë listën kur të na vie prona e veqantë edhe unë do të kërkojë shpejgim pse po kërkohet me u dhënë në shfrytëzim dhe qfarë do të bëhetë aty.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Bashkim Krasniqi.Mendoj që debati për këtë pikë të rendit të ditës është shterurë.Kush është për miratim të rekomandimit që ka ardhur nga MAPL-ja dhe pas trajtimit që është bërë nga zyra e Kryetarit?

Rezultati i votimit:

Për 16 vota.

Kundër 5 vota.

Abstenim 2 vota.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Vazhdojna me pikën e rendit të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtim dhe miratim i kërkesës nga MAPL-ja për Komitetin për Komunitete.Fjalën ja kalojë z.Muharremit.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor në Komunën e Malishevës):Ministria e ka listën që e ka miratuar Kuvendi mirëpo ata kanë kërkuarë që në këtë komisionë të përfshihenë anëtarë më shumë në këtë komitet dhe me qenë përfaqësuesi i tyre udhëheqës i Komitetit.Realishtë këtë parim që e kemi zbatuarë këtë herë ka qenë vazhdimishtë edhe herën e kaluarë sepse ne e dimë që komunitetet nuk kanë nivel të shkollimit që me udhëhequr komisione dhe ka udhëhequr gjithmonë njëri antarë prej Asamblesë.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Muharrem Morina.Fjalën e ka kërkuarë z.Hafir Rexha.Urdhëro.

Hafir Rexha(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Në njërën prej mbledhjeve e kemi miratuarë përbërjen e komitetit për komunitete,përbërja ka qenë si në listen vijues në shkresë:Hafir Rexha unë që e përfaqësojnë partinë Nisma Socialdemokrate,Fitim Shala,Nurie Islamaj përfaqësuese nga komuniteti rom,Naser Malisheva përfaqësues na komuniteti ashkali dhe Vjosa Shala është emëruar nga shoqëria civile kjo përbërje e plotësonë edhe strukturën gjinoren.Në mbledhjen e parë konstituive ne kemi bërë përpjekje që Kryesus/e ta emërojmë një përfaqësues nga komuniteti,mirëpo asnjëri prej tyre nuk kanë pranuarë dhe me shumicën e votave me votë anonime Kryesus i Komuniteteve është zgjedhur Fitim Shala dhe këtu në shkresën që e kanë kthyer thotë komunitet jo shumicë duhet me qenë të përfaqësuar dhe këtu të dy komitetet janë të përfaqësuar janë ashkali edhe rom ne komunitet tjetër nuk kemi,vetëm në qoftëse e ndronë dikush komunitetin dhe mendoj që kjo përbërje duhet me qenë ashtu siq është sepse ne nuk kemi komunitet tjetër,janë dy komunitete dhe të dyja janë të përfaqësuar nuk kanë dashur me qenë asnjëri Kryesus nga shoqëria civile e kemi një anëtare dhe komiteti është plotësishtë në përputhje me ligjin në fuqi.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Meqenëse është kriter që me u përfaqësuar prej komuniteteve zgjidheni ju formalishtë sa me u përmbushur ai kriter ligjor dhe mos me u kthyr prapë.

Hafir Rexha(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Unë nuk kam diqka tjetër me shtuarë vetëm me u hedh prapë në votim me këtë përbërje siq është emëruar.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit.Aty ku ceket që kërkohet së paku një përfaqësues i komuniteti ne vetëm e kemi e nëse dëshirojnë me i bërë nga dy prej një komuniteti

apo etnie.Unë mendoj që është mirë me qëndruar mbrapa vendimit të Asamblesë Komunale,nëse prapë kërkojnë diqka ndryshe veprojmë,por sipas dispozitave ligjore unë e vlersojë që jemi në rregullë.

Muharrem Morina(zyrtar ligjor në Komunën e Malishevës):Më lejoni të ju them një sqarim pse kemi ardhur deri tek kjo situatë,komiteti për komunitete në raste normale komuna e cila ka përfaqësim më të gjerë të komuniteteve përfaqësohet vetëm prej komuniteteve sepse komuniteti i tyre i kanë përfaqësuesit e tyre edhe në Kuvend por tek ne nuk ka pasur mundësi me u aplikuarë kjo normë përshkakë që nuk ka përfaqësues të komuniteteve në Kuvend.Së bashku me OSBE-në e kemi gjetur këtë qelës që me funksionuar ky komunitet duke e përfshirë shoqërinë civile edhe komunitetin rom duke e parë se pagesat janë të mira në komunitet, komuniteti rom që më herët është deklaruarë si rom janë vetë deklaruarë njëri rom e tjetri egjiptian për të marur pjesë më shumë në komunitet edhe këtë peng e kemi kaluar.Në mandatin e kaluarë kanë qenë të përfaqësuar dy anëtarë nga komuniteti.MAPL-ja e ka jepur një sqarim që për mendimin tim ka qenë i pakapshëm për mua.Unë nuk jam duke mundur me kuptuarë se qfarë janë duke thënë nëse ju i keni shkresat aty,nëse ju qëndroni prapa vendimit ky vendim prapë nuk do të kthehetë në Asamble,MAPL-ja e dërgonë lëndën në Ministrinë e Drejtësisë dhe na paditin në Gjykatë për këtë qështje kjo nuk është diqka që e dëmtonë imazhin e Komunës sepse ne nuk kemi mundësi tjetër me bërë sepse ata nuk e kthejnë në rishqyrtim prapë shkresën.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):A kanë kërkuarë specifikishtë që Kryesus/e me qenë përfaqësuesi nga komuniteti?

Muharrem Morina(zyrtar ligjor në Komunën e Malishevës):Aty në letër e vëreni që këto komitete i udhëheqin komunitetet që nënkuptonë që edhe përfaqësuesi i tyre me qenë Kryesus/e.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Muharrem.Unë e konsiderojë që duhet edhe njëherë ta trajtojnë anëtarët e komitetit këtë qështjen e Kryesusit në mbledhjen e parë dhe të kërkojnë që përfaqësusi nga komuniteti të zgjidhet Kryesus.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):A ka mundësi që kjo kërkesë të shtyhet për seancën e ardhshme,ky komision i komunitetit e mbanë një mbledhje e merrë një vendim?

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Nëse nuk ka dikush me marë fjalën për diskutim e hedhi në votim.Kush është për që të jetë e njejta përbërje e komisionit për komunitete dhe rekomandohet që komiteti ta zgjedhë Kryesusin nga komuniteti?

Rezultati i votimit:

Për 14 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 8 vota.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Kalojmë me pikën tjetër të rendit të ditës:Shqyrtim i kërkesës nga MAPL-ja për zgjedhjen e anëtarëve nëpër fshatra,këtu kemi të bëjmë me aspektin e përfaqësimit gjinorë,mendoj që te kjo kërkesë mundet me participuarë edhe zyra e Kryetarit edhe subjektet politike që të kenë përfaqësues në baza të njejta gjinore.Unë propozojë që partia Lidhja Demokratike e Kosovës ta ndryshonë dhe ta propozonë një emër të gjinisë femror.Fjalën e ka kërkuarë z.Halil Morina.Urdhëro

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit një përfaqësuese të gjinisë femrore e kemi,mirëpo duhet me qenë minimumi 4 nga gjinia femërore.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Atëherë LDK-ja e paraqetë një propozim para se me u marrë vendimi,sot i bie që nuk e kanë emërin nesër cekën në vendim përfaqësuesja nga LDK-ja dhe emrat e tjerë nga zyra e Kryetarit.Kush është për?

Rezultati i votimit:

Për 23 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 0 vota.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.Ftojë Drejtorin e Urbanizmit z.Avdi Morina ta paraqet kërkesës të cilën e ka parashtruarë.

Andi Morina(Drejtor i Urbanizmit):Faleminderit Kryesues.Sot ju kemi drejtuar me një kërkesë për shfuqizimin e vendimit për harta zonale.Kuvendi Komunal ka filluar me pregaditjen e hartave zonale nga viti 2012,procesi i hartave zonale është dërguarë në Ministri dhe është kthyer disa herë. Duke e pasur parasyshë që afati i planit zhvillimor komunalë skadonë në vitin 2027,ne jemi duke filluarë me parapregaditjet e zhvillimit komunal që është një dokument strategjikë dhe i rëndësishëm për Komunën e Malishevës me të cilën i kemi diskutuarë edhe me juve paraprakishtë,mendoj që duhet të shfuqizohet ky vendim për harta zonale dhe në të njejtën kohë të dy komponentë të rëndësishëm plani zhvillimor dhe harta zonale të punohenë nga fillimi dhe normalishtë që të miratohen në Kuvend sepse janë strukturat ligjore që i parashehë ligji dhe duhet të përmbushen.

Në të njejtën kohë kërkojë bashkëpunimin e të gjithë juve padallim sepse është një dokumentë i rëndësishëm që i prekë gjeneratat e ardhshme dhe kërkojë pa vonesë me i përfunduarë këto prodecura sepse kemi probleme me secilin vendbanim pastaj kemi akterë shumë të digastereve të ndryshme është një procesë shumë i gjatë dhe për këtë arsyeje ne këtë vitë duhet me filluarë që ta kemi të miratuarë për vitin 2027-të nga Kuvendi dhe të pranuarë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë.Faleminderit.

Kryesues i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit Drejtor.Urdhëroni dikush nga anëtarët e Asamblesë nëse keni me trajtuarë këtë kërkesë.Fjalën e ka kërkuarë z.Halil Morina.Urdhëro.

Halil Morina(anëtarë nga rradhët e partisë Nisma Socialdemokrate):Faleminderit Kryesus.Faleminderit Drejtor për shpejgimin,për neve është shumë e kuartë dhe shumë e domosdoshme që me u marrë ky vendim sepse ne sot nuk mundemi me hartuar harta zonale me një planë zhvillimorë që i del afati pasi një viti dhe nuk është në harmoni me të.Andaj unë e konsiderojë që është shumë e domosdoshme dhe fare nuk ka të bëjë me qështje politike kjo sepse kjo është qështje e interesit të përgjithshëm të Komunës së Malishevës dhe e gjithë ajo qfarë është e rëndësishme për mu është që të gjithë akterët me bërë maksimumin që sa ma shpejtë me u hartuarë një planë zhvillimor i duhur dhe harta zonale dhe që këtë qështje me hjekur një herë e mirë prej rendit të ditës sepse po na shkaktonë shumë probleme.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit z.Halil Morina.Fjalën e ka kërkuarë z.Enver Hoti.Urdhëro.

Enver Hoti(anëtarë nga rradhët e partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës):Pse nuk janë pranuar asnjëherë hartat zonale nga Ministria a keni ndonjë shpejgim,ku janë problemet,më duket shumë i rëndë shfuqizimi a kishte pasur mundësi me qenë një plotësim i vendimit me kërkuarë shtesë që korespondonë me planin e ardhshëm.Nëse ne e shfuqizojmë ndoshta ne marrim përgjegjësi më shumë.A është shmangur ndonjë papërgjigjësi që kemi pasur përballë atij vendimi që këkonë me u shfuqizuarë në tërësi?Pse me u shfuqizuarë kur mundet me u plotësuarë me një aneksë shtesë.

Burim Paçarizi(anëtarë nga rradhët e Partisë Demokratike të Kosovës):Unë pajtohem që plani zhvillimor komunal është njëri prej dokumenteve më të rëndësishme që mundet me pasur Kuvendi Komunal i Malishevës me të cilën secili prej neve ka me dhënë kontributin në këtë dokumentë që në të ardhmen të kemi një dokumentë të rëndësishëm.Komuna duhet të ketë një planë strategjikë të mirëfilltë që parashihen objektet e banimit kolektiv dhe individualë po ashtu edhe dokumentin e zhvillimit ekonomikë ku parashihen zonat e caktuara që Komuna e Malishevës të zhvillojë afarizëm.Ne e dim që Komuna jonë ka zona që në të ardhmen nëse futen mundemi me pasur edhe investime nga investitorë të jashtëm pasi që jemi një zonë e rëndësishme në qendër të Kosovës,mundë të kemi përfitime të mëdha nëse ky dokumentë i respektonë dhe i harmonizonë planin zhvillimorë të Kosovës.Ne si Parti Demokratike e Kosovës betohemi që kemi me dhënë kontributin në bazë të hartimit të këtij dokumenti që është shumë i rëndësishëm për Komunën e Malishevës.Uroj që ky dokumentë të realizohet brenda afatit kohorë dhe të miratohet nga Ministria e Mjedisit për Planifikim Hapësinorë.Faleminderit.

Kryesus i Kuvendit z.Fatmir Ademaj:Faleminderit.Fjalën ja kalojë Drejtorit të Urbanizmit.

Avdi Morina(Drejtor i Urbanizmit):Pyetjet ishin me vend.Kur tek hartat zonale nuk kemi një planë zhvillimor i cili nuk është në përputhje hartat zonale janë më të ulëta për nga hierarkia sesa plani zhvillimorë komunalë.Në momentin kur miratohet harta zonale ajo duhet me qenë në përputhje me planin zhvillimor.Ky është dokumenti në i rëndësishëm.Ne duhet me hartuar një dokumentë që i shërbenë të gjithë qytetarëve të komunës së Malishevës.Ne kemi raste te nënstacioni i cili në vitin 2019 nuk ka qenë i planifikuarë me planin zhvillimor komunal kemi pasur probleme të stërzgjatura nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor që të pajiset me letër të ndërtimit sepse janë objekte të kategorisë së tretë dhe me mirëkuptim i kemi futur këto dokumente dhe jemi pajisur me leje ndërtimi.Për këtë arsye ne kërkojmë me shfuqizuarë

këtë vendim me arsyeje që ne ti fillojmë procedurat me planin zhvillimor dhe njëkohësishtë me harta zonale.

Rezultati i votimit:

Për 22 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 3 vota.

Pika 9

Pika e nëntë: Të ndryshme

Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Hapi diskutim për këtë pikë të rendit të ditës. Fjalën e ka kërkuarë znj. Vlera Bytyçi. Urdhëro.

Vlera Bytyçi (anëtare nga rradhët e partisë Lëvizja Vetëvendosje): Unë e kam një pyetje për Drejtoreshën për Kulturë, Rini dhe Sportë edhe pse nuk është prezentë mirëpo ndoshta përgjigjen e marrë ndonjëherë. Sipas informacioneve ju vazhdoni me një kontratë për shërbime konsulente ndaj një personi të penzionuar. A mundet Drejtoresha apo dikush nga Drejtoria me na shpejguarë qfarë kontributi mundet me dhënë për Kulturë, Rini dhe Sportë?


Kryesues i Kuvendit z. Fatmir Ademaj: Faleminderit znj. Vlera, besoj që Drejtoresha do ti përgjigjet pyetjes tuaj.

Atëherë meqenëse nuk ka dikush me marrë fjalën po e mbyllim takimin e sotëm ju falenderojë të gjithëve për angazhimin e juaj në këtë seancë.

Takimi përfundoi rreth orës: 12:20

Procesëmbajtësja

Fatlume Delija



Kryesues i Kuvendit

Fatmir Ademaj

